



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.58**

**21 maj**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 268 datë 22.4.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për ndihmën e ndërsjellë në raste katastrofash ose fatkeqësish të mëdha”.....	2183
Ligj nr.10 269 datë 22.4.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rrugëve rajonale dhe lokale”.....	2188
Ligj nr.10 270 datë 22.4.2010	Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij.....	2202
Ligj nr.10 271 datë 22.4.2010	Për disa shtesa në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar .....	2207
Ligj nr.10 272 datë 29.4.2010	Për ratifikimin e protokollit të pestë shtesë të marrëveshjes “Për forcën shumëkombëshe të paqes në Europën Juglindore” .....	2208
Ligj nr.10 273 datë 29.4.2010	Për dokumentin elektronik .....	2217

**LIGJ**  
**Nr.10 268, datë 22.4.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË NË RASTE KATASTROFASH OSE FATKEQËSISH TË MËDHA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për ndihmën e ndërsjellë në raste katastrofash ose fatkeqësish të mëdha”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6551, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË MBI NDIHMËN E NDËRSJELLË NË RAST TË KATASTROFAVE OSE FATKEQËSIVE TË MËDHA**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Austrisë  
(të quajtura në vazhdim palë kontraktuese), të bindura për nevojën e bashkëpunimit midis të dyja shteteve, me qëllimin e lehtësimit të ndihmës së ndërsjellë në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

**Objekti**

Kjo marrëveshje rregullon kushtet e ndihmës vullnetare në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha që do të jepet mbi bazën e një kërkesë të parashtruar në rrugë diplomatike ose nga autoritetet e palës tjetër kontraktuese të përmendura në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet ndërhyrjes së skuadrave ndihmëse, të individëve të dërguar për dhënien e ndihmës, të materialeve ose të informacioneve.

Neni 2

**Përkufizimet**

Në këtë marrëveshje termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

- “Katastrofa ose fatkeqësia e madhe”:

Një incident i jashtëzakonshëm që ka ndodhur ose mund të ndodhë së shpejti, i dalë pjesërisht ose plotësisht jashtë kontrollit, i kufizuar në kohë dhe në hapësirë, i cili krijohet në lidhje me shfrytëzimin e pajisjeve teknike, forcat natyrore shkatërruese, manovrimin e lëndëve të rrezikshme dhe transportimin e tyre dhe mund të bëhet një rrezik për jetën ose shëndetin e njeriut dhe të kafshëve, të

kërcënojë mjedisin, të rrezikojë pronën, të shkaktojë humbje ekonomike të rëndësishme ose dëmtime ekologjike dhe për përballimin e të cilit forcat e veta të palës kontraktuese në fjalë nuk mjaftojnë.

- “Shteti ndihmëkërkuar”:

Ajo palë kontraktuese, autoriteti i së cilës, i përmendur në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, i kërkon palës tjetër kontraktuese ndihmë.

- “Shteti ndihmëdhënës”:

Ajo palë kontraktuese, autoriteti i së cilës, i përmendur në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, plotëson një kërkesë për ndihmë të palës tjetër kontraktuese.

- “Pajisjet”:

Materiali, veçanërisht veglat teknike, mjetet e transportit dhe qentë e shpëtimit për ndërhyrjen, si dhe mallrat për nevojën e vet.

- “Ndihamat”:

Mallrat e destinuar për dorëzimin falas popullsisë që ka pësuar katastrofën ose fatkeqësinë e madhe në territorin e shtetit ndihmëkërkuar.

- “Skuadrat ndihmëse”:

Njësi civile ose ushtarake të specializuara me pajisjet dhe ndihamat përkatëse, të caktuara nga shteti ndihmëdhënës për dhënien e ndihmës;

- “Individët e caktuar për dhënien e ndihmës”.

Një ose më shumë persona me pajisjet dhe ndihamat përkatëse, të caktuar nga shteti ndihmëdhënës për dhënien e ndihmës.

### Neni 3

#### **Kompetencat**

1) Pa cenuar rrugën diplomatike, autoritetet kompetente për parashtrimin dhe për pranimin e kërkesave për ndihmë, si dhe për format e tjera të bashkëpunimit të parashikuar në këtë marrëveshje janë:

- nga ana e Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Brendshme;

- nga ana e Republikës së Austrisë:

Ministri Federal për Punë të Brendshme.

2) Palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike për adresat dhe lidhjet e telekomunikacionit të autoriteteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, si edhe të zyrave të tyre të kontaktit. Për zyrat e kontaktit do të ekzistojë mundësia të kontaktohen gjithmonë.

3) Autoritetet e palëve kontraktuese, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, janë të autorizuar të lidhen me njëra-tjetrën në mënyrë direkte për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

4) Palëve kontraktuese informojnë njëra-tjetrën menjëherë mbi ndryshimet që kanë të bëjnë me kompetencat e autoriteteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

### Neni 4

#### **Lloji dhe përmasat e ndihmës**

1) Ndihma mund të jepet nëpërmjet ndërhyrjes së skuadrave ndihmëse ose të individëve të dërguar për dhënien e ndihmës, nëpërmjet dërgimit të ndihmave ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme, në një rast të tillë do të merret vesh midis autoriteteve të përmendura në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje në kuadër të kërkesës për ndihmë për llojin dhe përmasat e ndihmës.

2) Autoriteti kërkuar parashtron kërkesën për ndihmë sipas mundësive në gjuhën e palës kontraktuese së kërkuar ose në gjuhën angleze.

3) Skuadrat ndihmëse mund të vihen në përdorim për shuarjen e zjarreve në pyje dhe zjarreve të tjera me rrezikshmëri të lartë në sipërfaqe të mëdha, për luftimin e rreziqeve bërthamore dhe kimike, si dhe të katastrofave dhe të fatkeqësive të tjera të mëdha, veçanërisht me mjete ajrore për shuarjen e zjarreve, ndihmë mjekësore, kërkim – shpëtim, dhe lloje të tjera të masave ndihmëse. Ato duhet të kenë kualifikimin dhe pajisjet e nevojshme për këtë qëllim.

4) Transporti i skuadrave ndihmëse ose i individëve të dërguar për dhënien e ndihmës, i pajisjeve dhe i ndihmave mund të bëhet në rrugë tokësore, ajrore ose ujore.

Neni 5  
**Kalimi i kufirit dhe qëndrimi**

1) Për të siguruar efikasitetin e nevojshëm për dhënien e shpejtë të ndihmës, palët kontraktuese angazhohen t'i kufizojnë formalitetet për kalimin e kufirit në minimumin e domosdoshëm.

2) Gjatë periudhës së dhënies së ndihmës anëtarët e një skuadre ndihmëse mund të qëndrojnë në territorin e shtetit ndihmëkërkues pa vizë dhe pa lejeqëndrimi. Në rastet kur i kërkohet, udhëheqësi i skuadrës ndihmëse duhet të paraqesë një dëshmi për pozicionin e tij ose urdhrin e tij dhe një listë me emrat e anëtarëve të skuadrës ndihmëse, të dyja në gjuhën e shtetit ndihmëkërkues ose në gjuhën angleze.

3) Për veprimtarinë e tyre në kuadrin e dhënies së një ndihme mbi territorin e palës tjetër kontraktuese anëtarët e një skuadre ndihmëse dhe individët e dërguar për dhënien e ndihmës nuk kanë nevojë për një leje pune.

4) Anëtarët e një skuadre ndihmëse kanë të drejtë të mbajnë një uniformë mbi territorin e shtetit ndihmëkërkues, nëse mbajtja e uniformës është pjesë e pajisjes së tyre të zakonshme. Skuadra ndihmëse e shtetit ndihmëdhënës ka të drejtë të përdorë mbi territorin e shtetit ndihmëkërkues në mjetet e tyre shenjat e tyre paralajmëruese.

Neni 6  
**Kalimi i kufirit i pajisjeve dhe i ndihmave**

1) Palët kontraktuese lehtësojnë importin dhe eksportin e pajisjeve dhe të ndihmave.

2) Kur hyn në territorin e tyre, udhëheqësi i një skuadre ndihmëse duhet t'u dorëzojë organeve të kontrollit kufitar ose të doganës së shtetit ndihmëkërkues vetëm një listë të pajisjeve dhe të ndihmave të sjellura në gjuhën e palës kontraktuese kërkuese ose në gjuhën angleze.

3) Anëtarëve të një skuadre ndihmëse ose individëve të dërguar për dhënien e ndihmës nuk u lejohe të sjellin mallra të tjera, përveç pajisjeve dhe ndihmave. Nuk lejohe të sjellja e armëve të zjarrit dhe e municionit në territorin e shtetit ndihmëkërkues.

4) Pajisjeve dhe ndihmave nuk u aplikohen ndalimet dhe kufizimet e trafikut ndërkombëtar të mallrave. Nëse pajisjet nuk konsumohen ose shkatërrohen, ato duhet të eksportohen përsëri nga shteti ndihmëkërkues. Nëse një pajisje lihet si ndihmë, autoriteti i shtetit ndihmëkërkues, i përmendur në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, duhet të njoftohet për llojin dhe sasinë, si edhe për vendin ku ka mbetur që të informojë pikën doganore kompetente mbi të.

5) Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni i aplikohen edhe importit të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope në shtetin ndihmëkërkues dhe rieksporimit të sasive të pakonsumuara në shtetin ndihmëdhënës. Ky trafik mallrash nuk do të konsiderohet si import dhe eksport në kuptimin e konventave ndërkombëtare mbi drogat narkotike dhe substancat psikotrope. Drogat narkotike dhe substancat psikotrope duhet të sillen vetëm në rastin e nevojës mjekësore urgjente dhe duhet të aplikohen vetëm nga një personel mjekësor i kualifikuar, sipas dispozitave ligjore të palës kontraktuese në të cilën bën pjesë skuadra ndihmëse ose personi i dërguar për dhënien e ndihmës. Drogat narkotike dhe substancat psikotrope të konsumuara do të përfshihen në statistikën e konsumit të shtetit ndihmëdhënës.

6) Në rastin e reciprocitetit palët kontraktuese do të lejojnë përdorimin e përkohshëm të pataksuar të pajisjeve në shtetin ndihmëkërkues pa procedurë formale dhe pa dhënie të një garancie duke i liruar ato, si dhe ndihmat nga të gjitha taksat doganore, tatimet dhe taksat e tjera hyrjeje, nëse konsumohen ose mbeten në shtetin ndihmëkërkues.

Neni 7  
**Përdorimi i mjeteve fluturuese**

1) Mjetet fluturuese mund të përdoren jo vetëm për sjelljen e shpejtë të skuadrave ndihmëse sipas paragrafit 4 të nenit 4 të kësaj marrëveshjeje, por drejtpërsëdrejti edhe për llojet e tjera të dhënies së ndihmës.

2) Çdo palë kontraktuese lejon që mjetet fluturuese që përdoren, sipas paragrafit 1 të këtij neni, pasi nisen nga territori i palës tjetër kontraktuese të fluturojnë mbi territorin e saj dhe të ulen dhe të ngrihen edhe jashtë aerodromeve doganore dhe fushave të autorizuara fluturimi.

3) Për përdorimin e mjeteve fluturuese në rast të një ndërhyrjeje ndihmëse duhet të njoftohen menjëherë qendrat kompetente të kontrollit ajror duke iu referuar kësaj marrëveshjeje dhe duke u komunikuar të dhënat sa më të detajuara mbi llojin dhe shenjën e mjetit fluturues, ekuipazhin, ngarkesën, orën e nisjes, itinerarin e parashikuar dhe vendin e uljes.

4) Për analogji u aplikohen:

a) neni 5 i kësaj marrëveshjeje ekuipazheve dhe skuadrave ndihmëse që fluturojnë me to;

b) neni 6 i kësaj marrëveshjeje mjeteve fluturuese dhe pajisjeve të tjera dhe ndihmave të sjellura.

5) Përderisa nuk rezulton ndryshe nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të aplikohen dispozitat aeronautike të secilës palë kontraktuese.

6) Përdorimi i mjeteve fluturuese ushtarake lejohet vetëm me miratimin e shtetit ndihmëkërkues.

#### Neni 8

### **Koordinimi dhe drejtimi i përgjithshëm**

1) Koordinimi dhe drejtimi i punëve të shpëtimit dhe i ndihmës u takojnë autoriteteve të shtetit ndihmëkërkues.

2) Porositë ndaj skuadrave ndihmëse të shtetit ndihmëdhënës u drejtohen pa përjashtim udhëheqësve të tyre që do t'ua urdhërojnë forcave nën urdhrin e tyre mënyrën e zbatimit.

3) Autoritetet e shtetit ndihmëkërkues u akordojnë skuadrave ndihmëse ose individëve të dërguar për dhënien e ndihmës të shtetit ndihmëdhënës mbrojtje dhe ndihmë në kuadrin e kompetencave të tyre.

#### Neni 9

### **Shpenzimet e ndërhyrjes**

1) Shteti ndihmëdhënës nuk ka asnjë të drejtë kundrejt shtetit ndihmëkërkues për kompensimin e shpenzimeve për ndihmën e dhënë. Kjo vlen edhe për shpenzimet që rezultojnë nga konsumimi, dëmtimi ose humbja e pajisjeve.

2) Në rast të rekuperimit të plotë ose të pjesshëm të shpenzimeve për dhënien e ndihmës paragrafi 1 i këtij neni nuk do të jetë i vlefshëm. Shteti ndihmëdhënës do të zhdëmtohet me përparësi.

3) Shteti ndihmëkërkues mban shpenzimet e ndihmës së dhënë nga personat fizikë dhe juridikë që shteti ndihmëdhënës ka vetëm ndërmjetësuar në bazë të një kërkesë.

4) Në rast nevoje u akordohet skuadrave ndihmëse dhe individëve të dërguar për dhënien e ndihmës së shtetit ndihmëdhënës për kohëzgjatjen e ndërhyrjes në shtetin ndihmëkërkues me shpenzimet e tij një mbështetje të parë logjistike, përfshirë edhe përkujdesjen e parë mjekësore.

#### Neni 10

### **Dëmshpërblimi dhe zhdëmtimi**

1) Çdo palë kontraktuese heq dorë nga të gjitha pretendimet që i takojnë kundrejt palës tjetër kontraktuese ose personave të saj të caktuar për dhënien e ndihmës përsa i përket zhdëmtimit:

a) të dëmeve pasurore të shkaktuara nga një person i caktuar për dhënien e ndihmës në lidhje me përmbushjen e detyrës së tij;

b) të dëmeve që rezultojnë nga lëndimi trupor, nga dëmtimi i shëndetit ose nga vdekja e një personi të caktuar për dhënien e ndihmës në lidhje me përmbushjen e detyrës së tij.

Kjo nuk është e vlefshme, nëse dëmi u shkaktua me qëllim ose pakujdesi të rëndë.

2) Nëse u shkaktohet të tretëve një dëm nga një person i shtetit ndihmëdhënës i caktuar për dhënien e ndihmës në lidhje me përmbushjen e detyrës së tij mbi territorin e shtetit ndihmëkërkues, shteti ndihmëkërkues përgjigjet për dëmin sipas dispozitave ligjore që do të aplikoheshin në rastin e një dëmi të shkaktuar nga personat e vet të caktuar për dhënien e ndihmës.

3) Shteti ndihmëkërkues nuk ka asnjë të drejtë zhdëmtimi kundrejt shtetit ndihmëdhënës ose personave të tij të caktuar për dhënien e ndihmës. Por në rastin kur një person i shtetit ndihmëdhënës, i caktuar për dhënien e ndihmës, i shkaktonte një të treti, me qëllim ose pakujdesi të rëndë, një dëm, shteti ndihmëkërkues mund të paraqesë kundër shtetit ndihmëdhënës një kërkesë për zhdëmtim.

4) Palët kontraktuese, bashkëpunojnë ngushtë me njëra – tjetrën, në përputhje me dispozitat ligjore të tyre të brendshme për të lehtësuar zgjidhjen e pretendimeve për dëmshpërblimet ose

zhdëmtimet. Ato shkëmbejnë veçanërisht të gjitha informacionet që disponojnë mbi dëmet e parashikuara në këtë nen.

Neni 11

### **Lidhjet e telekomunikacionit**

Autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një lidhje të qëndrueshme midis autoriteteve dhe skuadrave ndihmëse në vendin e ndërhyrjes.

Neni 12

### **Mbarimi i ndihmës**

Skuadrat ndihmëse ose individët e dërguar për dhënien e ndihmës mbarojnë veprimtarinë e tyre, nëse shteti ndihmëkërkuar e kërkon, përndryshe pas përbushjes së detyrave të tyre.

Neni 13

### **Forma të tjera bashkëpunimi**

1) Palët kontraktuese bashkëpunojnë me njëra – tjetrën në përputhje me legjislacionin e brendshëm, veçanërisht:

a) për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve të tipit shkencor-teknik dhe parashikimit të takimeve, të programeve kërkimore, të kurseve të specializuara dhe të stërvitjeve për ndërhyrjet ndihmëse mbi territorin e të dyja palëve kontraktuese;

b) për shkëmbimin e informacioneve mbi rreziqet dhe dëmet që lindin dhe mund të kenë pasojë gjithashtu për territorin e palës tjetër kontraktuese; informimi i ndërsjellë përfshin edhe transmetimin e të dhënave të matura.

2) Për bashkëpunimin në fushën e kualifikimit, si dhe për stërvitjet e përbashkëta, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlejnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje për analogji.

3) Bashkëpunimi në fushën e kualifikimit mund të realizohet veçanërisht:

a) në formën e takimeve të ekspertëve;

b) nëpërmjet pjesëmarrjes në kurse të specializuara.

4) Shpenzimet e krijuara nga bashkëpunimi në fushën e kualifikimit do të mbahen si vijon:

a) pala kontraktuese dërguese merr përsipër shpenzimet e udhëtimit vajtje- ardhje të pjesëmarrësve të saj, si dhe shpenzimet për ritransportimin e tyre në rast sëmundjeje ose vdekjeje;

b) shteti pritës merr përsipër shpenzimet e strehimit dhe të ushqimit, si edhe të përkujdesjes së parë mjekësore.

Neni 14

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhen drejtpërdrejt nga autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen nga palët kontraktuese në rrugë diplomatike.

Neni 15

### **Raporti i kësaj marrëveshjeje me rregullimet e tjera kontraktuale**

Rregullimet kontraktuale ekzistuese midis palëve kontraktuese nuk preken nga kjo marrëveshje.

Neni 16

### **Dispozitat përfundimtare**

1) Kjo marrëveshje lidhet për një kohë të pacaktuar.

2) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin palët kontraktuese do të kenë informuar njëra-tjetrën me shkrim në rrugë diplomatike mbi plotësimin e kushteve të brendshme përkatëse për hyrjen në fuqi.

3) Kjo marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë me shkrim në rrugë diplomatike; në këtë rast shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së marrjes të denoncimit.

E bërë në Vjenë, më 27.1.2010 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane, duke qenë të dyja tekstet njësoj autentike.

**LIGJ**  
**Nr.10 269, datë 22.4.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6552, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE HUAJE**  
**(PROJEKTI I RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE)**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BANKA), MARS 2010**

Preambulë

*Ndërsa* Banka është themeluar për të dhënë financim për projekte të veçanta për të lehtësuar tranzicionin drejt ekonomive të hapura dhe të orientuara nga tregu dhe për të nxitur iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore që i janë përkushtuar dhe zbatojnë parimet e demokracisë pluripartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

*Ndërsa* Huamarrësi synon të zbatojë projektin sipas përshkrimit të skedulit 1 që është hartuar për të ndihmuar Huamarrësin në rehabilitimin e rrjetit rrugor rajonal dhe lokal në Republikën e Shqipërisë;

*Ndërsa* Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

*Ndërsa* Huamarrësi synon të kontrakttojë një hua nga Banka Europiane e Investimeve (EIB) në shumën prej 50 000 000 eurosh (pesëdhjetë milionë euro) për të asistuar në financimin e pjesës B të projektit, në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në një marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe EIB-it (kontrata e financimit nga EIB);

*Ndërsa* Bashkimi Europian, nëpërmjet instrumentit të tij për programet e asistencës së paraademit për vitet 2010 dhe 2011 (IPA), është në procesin e dhënies së fondeve të grandeve për të financuar pjesën B të projektit, këto grande janë në një shumë të përgjithshme prej 33 000 000 eurosh (tridhjetë e tre milionë euro), nga të cilat të paktën 15 000 000 euro (pesëmbëdhjetë milionë euro), sipas IPA 2010, në pajtim me termat e një ose më shumë marrëveshjeve grandit ndërmjet IPA-s dhe Huamarrësit (marrëveshjet e grandit IPA);

*Ndërsa* Banka dhe EIB janë në procesin e rregullimit të fondeve për bashkëpunimin teknik mbi bazë grandit për kuadrin e investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për të asistuar Huamarrësin për të zbatuar pjesët A, C, D, E dhe F të projektit; dhe

*Ndërsa* Banka ka rënë dakord që, midis të tjerash, mbi bazën e sa më sipër, të japë një hua për Huamarrësin në shumën prej 50 000 000 eurosh (pesëdhjetë milionë euro) në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje,

*kështu*, palët bien dakord si më poshtë:

## Neni 1

### Termt dhe kushtet standarde; përkufizime

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës, të datës 1 tetor 2007, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashikuar plotësisht këtu.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe skedulet), nëse nuk përcaktohet ndryshe apo konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përkufizuara në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u jepen atje, ndërsa termat e përkufizuara në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u jepen atyre atje dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"FSHZH" është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

"Autoriteti Shqiptar i Rrugëve" është agjencia e rrugëve që do të themelohet në Republikën e Shqipërisë.

"Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit" është Ministri i Financave i Huamarrësit.

"Kërkesat e përcaktuara të efektshmërisë" janë kërkesat e efektshmërisë nga 1 deri 8 dhe 10 (ose, nëse konteksti i kërkon ndryshe, një prej këtyre kërkesave të efektshmërisë) të kërkesave të efektshmërisë të datës maj 2008 dhe në lidhje me politikën ambientaliste dhe sociale të Bankës të majit 2008.

"Plani i veprimit social dhe ambientalist" është plani i masave të zbutjes dhe përmirësimit social dhe ambientalist të datës 23 shkurt 2010, një kopje e të cilit është bashkëngjitur si skeduli 4, ku ky plan mund të ndryshohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës në pajtim me seksionin 3.03(d).

"Ligji ambientalist dhe social" nënkupton çdo ligj ose rregullore të zbatueshme në lidhje me:

a) ndotjen ose mbrojtjen e ambientit, duke përfshirë ligjet dhe rregulloret përkatëse në lidhje me mundësimin e informacionit për publikun dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje;

b) kushtet e punës dhe të punësimit;

c) shëndetin dhe sigurinë në punë;

d) shëndetin dhe sigurinë publike;

e) popujt autoktonë;

f) trashëgiminë kulturore; ose

g) rivendosjen ose zhvendosjen ekonomike të personave.

"Çështjet e ambientit dhe sociale" është çdo çështje që është objekt i një ligji ambientalist dhe social, çdo kërkesë të përcaktuar të efektshmërisë ose plani të veprimit ambientalist dhe social.

"Viti fiskal" është viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

"Llogari e veçantë" është llogaria e veçantë e depozitës së përmendur në seksionin 2.03 dhe skedulën 3.

"Marrëveshja e nivelit të shërbimit" është një marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Autoritetit Shqiptar të Rrugëve që rregullon raportin ndërmjet palëve në këtë marrëveshje që përcakton përgjegjësitë për Autoritetin Shqiptar të Rrugëve si dhënësi i shërbimeve dhe niveleve të financimit nga



Qeveria Shqiptare si blerës i shërbimeve.

#### Seksioni 1.03 Interpretimi

Një referencë në një nen, seksion ose skedul të caktuar në këtë Marrëveshje, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si një referencë në atë nen ose seksion apo skedul të kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 2

#### Termat kryesore të huasë

##### Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

a) Në pajtim me paragrafin (c) të mëposhtëm, Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, me termat dhe kushtet e parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 50 000 000 eurosh (pesëdhjetë milionë euro).

b) Huaja përbëhet nga dy transhe, si më poshtë:

1. Transhi A, në shumën prej 25 000 000 eurosh (njëzet e pesë milionë euro); dhe

2. Transhi B, në shumën prej 25 000 000 eurosh (njëzet e pesë milionë euro).

c) Asnjë tërheqje nuk mund të bëhet sipas transhit B, nëse Banka nuk ka vendosur sipas diskrecionit të saj dhe ka informuar Huamarrësin me shkrim që transhi B i ofrohet Huamarrësit.

##### Seksioni 2.02 Terma të tjera financiare të huasë

a) Shuma minimale e tërheqjes është 250 000 euro.

b) Shuma minimale e parapagimit është 5 000 000 euro.

c) Shuma minimale e anulimit është 1 000 000 euro.

d) Datat e pagesës së interesit janë 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi e shlyen transhin A në 24 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) më 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti, dhe data e parë e shlyerjes së huasë për transhin A është më 30 prill 2013 dhe data e fundit e shlyerjes së huasë është 30 tetor 2025.

2. Huamarrësi shlyen transhin B në 24 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) më 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti, dhe data e parë e shlyerjes së huasë për transhin B është data e pagesës së interesit menjëherë pas përvjetorit të tretë të datës së njoftimit të Bankës drejtuar Huamarrësit, ku Banka konfirmon se: i) të gjitha kushtet e renditura në seksionin 6.03 janë përmbushur dhe ii) ajo synon t'i vërë në dispozicion Huamarrësit transhin B.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin kur: i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë transhin A dhe/ose, sipas rastit, transhi B vjen para datës së parë të shlyerjes së huasë për transhin A ose datës së parë për shlyerjen e huasë për transhin B, përkatësisht, të përcaktuara në këtë seksion 2.02.(e), dhe ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë së përcaktuar në seksionin 2.02.(f) në lidhje me transhin A dhe/ose, sipas rastit, transhit B më poshtë në një datë që bie pas datës së parë përkatëse të shlyerjes së huasë, atëherë shuma për secilën tërheqje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së huasë alokohet për shlyerje në shumën të barabarta në disa data të shlyerjes së huasë që bien pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka përshtat shumën e alokuara sipas nevojës për të realizuar numra të plotë në secilin rast). Banka, herë pas here, njofton Huamarrësin për këto alokime.

f) 1. Data e fundit e disponueshmërisë për transhin A është 31 marsi 2013 ose një datë e mëvonshme që Banka mund të vendosë në zgjedhjen e saj dhe njoftojë Huamarrësin.

2. Data e fundit e disponueshmërisë për transhin B është data që bie në përvjetorin e tretë të datës së njoftimit nga Banka drejtuar Huamarrësit, ku Banka konfirmon që: i) janë përmbushur të gjitha kushtet e renditura në seksionin 6.03 dhe ii) ajo synon t'i ofrojë transhin B Huamarrësit, apo në një datë të mëvonshme që Banka mund të vendosë në zgjedhjen e saj dhe njoftojë Huamarrësin.

3. Nëse shuma e disponueshme e huasë, ose një pjesë e saj, i nënshtrohet një norme fikse interesi dhe Banka e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë të ndonjërit prej transhit A apo transhit B, Huamarrësi i paguan menjëherë Bankës atë shumë për koston e ndryshuar që i njoftohet here pas here nga Banka me shkrim Huamarrësit.

g) Norma e komisionit të angazhimit është 0.5% në vit. Asnjë komision angazhimi nuk është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në lidhje me transhin B derisa Banka të informojë Huamarrësin me shkrim që transhi B i është ofruar Huamarrësit.

h) Huaja i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi. Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi, si alternativë ndaj pagesës së interesit me një normë të ndryshueshme interesi për të gjithë

ose një pjesë të huasë së pashlyer, mund të zgjedhë pagesën e interesit me një normë interesi fiks për këtë pjesë të huasë në pajtim me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

#### Seksioni 2.03 Tërheqjet dhe llogaria e veçantë

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në pajtim me dispozitat e skedulit 2 për të financuar: 1) shpenzimet e bëra (ose, nëse bie dakord Banka, që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve që kërkohen për projektin, dhe 2) komisionin e fillimit.

b) Huamarrësi, për qëllimet e projektit, hap dhe mban një llogari të veçantë depozite të përcaktuar në monedhën e huasë në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën, duke përfshirë mbrojtjen e përshtatshme ndaj kompensimit, konfiskimit dhe sekuestrimit. Nëse Huamarrësi dëshiron të bëjë tërheqje për depozitë në, dhe pagesat e drejtpërdrejta nga llogaria e veçantë (në vend të tërheqjeve në pajtim me seksionin 2.03(a)), këto tërheqje bëhen në pajtim me dispozitat e skedulit 3.

#### Seksioni 2.04 Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjet

Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit për qëllimet e ndërmarrjes së çdo veprimi që kërkohet ose lejohet për t'u ndërmarrë sipas dispozitave të seksionit 2.03(a) dhe sipas dispozitave të seksionit 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde.

### Neni 3

#### **Ekzekutimi i projektit**

#### Seksioni 3.01 Angazhime të tjera konfirmuese të projektit

Përveç detyrimeve të përgjithshme të parashikuara në nenin IV të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Merr të gjitha masat e nevojshme për të zbatuar marrëveshjen e nivelit të shërbimit për Autoritetin Shqiptar të Rrugëve jo më vonë se 31 dhjetor 2010;

b) Merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që FZSHH-ja të miratojë planin e tyre afatmesëm të biznesit jo më vonë se 31 dhjetori 2011;

c) Merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që FZSHH-ja të ketë burime të mjaftueshme financiare për të zbatuar projektin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij;

d) Merr të gjitha masat e nevojshme për të kontraktuar sektorin privat për të gjithë mirëmbajtjen periodike dhe rutinë të: i) rrugëve kombëtare jo më vonë se 30 qershor 2011 dhe ii) një pjesë të rrugëve rajonale që përfaqësojnë të paktën 50% të të gjithë rrjetit rajonal të rrugëve të Huamarrësit jo më vonë se 31 dhjetori 2012;

e) Merr të gjitha masat e nevojshme për të rritur fondet për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve për mirëmbajtjen e rrugëve (dhe, pasi të jetë funksional, Autoriteti Shqiptar i Rrugëve) gjatë çdo viti financiar që fillon më 1 janar 2011, 1 janar 2012 dhe 1 janar 2013 me të paktën 10% të financimit që është dhënë gjatë vitit paraardhës financiar;

f) Merr të gjitha masat e nevojshme për të përfunduar projektet pilot për kontratat e mirëmbajtjes bazuar mbi rezultatet jo më vonë se fundi i vitit 2012;

g) Merr të gjitha masat e nevojshme për të arritur që Autoriteti Shqiptar i Rrugëve të jetë përgjegjës për administrimin e të gjithë rrjetit rrugor rajonal të Huamarrësit jo më vonë se 31 dhjetori 2013; dhe

h) Merr të gjitha masat e nevojshme që të realizohet një auditim i jashtëm teknik i punëve të ndërmarra nga FZSHH-ja në një pjesë të seksioneve të rrugëve, financuar nga kjo hua jo më vonë se 31 dhjetori 2012.

#### Seksioni 3.02 Prokurimi

Për qëllimet e seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, dispozitat e mëposhtme, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe që financohen nga shumat e huasë:

a) Mallrat, punët dhe shërbimet (të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve që përfshihen brenda seksionit 3.02(c)) prokurohen me tenderim të hapur dhe, në raste të veçanta me pëlqimin paraprak të Bankës, nëpërmjet tenderimit konkurrues lokal.

b) Për qëllimet e seksionit 3.02(a), procedurat për tenderim të hapur dhe standardet për procedurat e tenderimit konkurrues lokal caktohen në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të EBRD-së.

c) Konsulentët që punësohen nga Huamarrësi për të asistuar në zbatimin e projektit përzgjidhen në pajtim me procedurat e parashikuara në kapitullin 5 të rregullave të prokurimit të EBRD-së.

d) Tri kontratat e para për punët civile ose paketat e prokurimit që financohen në bazë të projektit i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës ndërsa të gjitha kontratat pasuese ose paketat e prokurimit i nënshtrohen rishikimit pasues të Bankës, në pajtim me paragrafin 3.39 të rregullave të prokurimit të EBRD-së.

e) Për çdo kontratë në lidhje me të cilën duhet të bëhet pagesë nga llogaria e veçantë, respektohen procedurat e prokurimit që sigurojnë që kërkesat e rishikimit të seksionit 3.02(d) përmbushen para bërjes së pagesës së parë nga llogaria e veçantë në lidhje me këtë kontratë.

Seksioni 3.03 Kushte të përputhshmërisë me ambientin dhe sociale

Pa kufizuar përgjithësimin e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, dhe përveç kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Përveç kur përcaktohet ndryshe në planin e veprimit ambientalist dhe social, Huamarrësi, duke detyruar për këtë edhe çdo kontraktor, e zbaton projektin në pajtim me kërkesat e projektuara të efektshmërisë;

b) Pa u kufizuar në sa më sipër, Huamarrësi zbaton me kujdes dhe respekton planin e veprimit ambientalist dhe social dhe monitoron zbatimin e këtij plani në pajtim me dispozitat e monitorimit që gjenden në këtë plan;

c) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here, mund të bien dakord të ndryshojnë planin e veprimit ambientalist dhe social në përgjigje të ndryshimeve në rrethanat e projektit ose Huamarrësit, ngjarjeve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit, duke përfshirë rezultatet e çdo auditimi që zhvillohet në pajtim me këtë seksion 3.03(d). Pa kufizuar përgjithësimin e sa më sipër:

1. nëse ka ndonjë ndikim negativ ambientalist ose social apo çështje që nuk është parashikuar ose përcaktuar në planin e veprimit ambientalist dhe social, në lidhje me të tërin ose vetëm me ashpërsinë e tij, ose

2. nëse një masë për lehtësimin e ndikimit, e parashikuar në planin e veprimit ambientalist ose social nuk është e mjaftueshme për të eliminuar ose pakësuar një ndikim ambientalist ose social në masën e parashikuar nga kërkesat e parashikuara të efektshmërisë brenda afatit kohor të përcaktuar në planin e veprimit ambientalist dhe social,

Huamarrësi, me pëlqimin e Bankës, zhvillon sa më parë të jetë e mundur dhe përfshin në planin e veprimit ambientalist dhe social ato masa shtesë ose të rishikuara lehtësimi që mund të jenë të nevojshme për të arritur përputhjen me kërkesat e parashikuara të efektshmërisë, në çdo rast në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

d) Para fillimit të ndonjë pune ndërtimi në lidhje me çdo nënprojekt, Huamarrësi merr masa që të realizohet një studim i përshtatshëm ambientalist dhe social për çdo nënprojekt të pranueshëm për Bankën, në pajtim me planin e veprimit ambientalist dhe social.

Seksioni 3.04 Konsulentët

a) Me qëllim që të asistojë në zbatimin e projektit, Huamarrësi, përveç kur bihet dakord ndryshe nga Banka, punëson ose merr masa për punësimin, sipas rastit, dhe përdor konsulentë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të pranueshme për Bankën, duke përfshirë:

1. Konsulentët për përgatitjen e projekteve inxhinierike (duke përfshirë vlerësimin e ndikimit ambientalist dhe social për nënprojektet), pjesë e zbatimit të projektit sipas parashikimit në pjesën A;

2. Konsulentët për mbikëqyrjen e punëve të ndërtimit për projektin, sipas parashikimit në pjesën C;

3. Konsulenti monitorues i Huadhënësit për të asistuar Bankën në monitorimin e zbatimit të projektit (duke përfshirë rezultatet ambientaliste dhe sociale) në emër të bankave, siç përcaktohet në pjesën D;

4. Konsulentët për dhënien e mbështetjes zbatuese për FZSHH-në sipas parashikimit në pjesën E;

5. Konsulentët për të asistuar FZSHH-në për përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale sipas parashikimit në pjesën F; dhe

6. Konsulentët për të asistuar në auditimin e jashtëm teknik sipas parashikimit të seksionit 3.01(f).

b) Huamarrësi i jep falas çdo konsulent të përfshirë për të asistuar në çështjet në lidhje me projektin ose veprimet e Huamarrësit të gjithë mbështetjen e nevojshme për të përmbushur funksionet e

tyre, duke përfshirë të gjitha dokumentet, materialet dhe informacion tjetër që mund të jetë i lidhur me punën e tyre.

#### Seksioni 3.05 Shpeshësia e raportimit dhe kërkesat e paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, deri sa të shlyhet ose anulohet shuma e plotë e huasë, FZSHH-ja, në emër të Huamarrësit, i paraqet Bankës raporte vjetore mbi çështjet ambientaliste dhe sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose projektin brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas fundit të vitit për të cilin raportohet. Këto raporte përfshijnë informacion mbi çështjet e mëposhtme specifike:

1. Informacion mbi përputhshmërinë nga Huamarrësi me kërkesat e parashikuara të efektshmërisë sipas parashikimit në seksionin 3.03(a) dhe zbatimin e planit të veprimit ambientalist dhe social;

2. Informacion mbi mënyrën si Huamarrësi ka monitoruar përputhshmërinë me kërkesat e parashikuara të efektshmërisë dhe planin e veprimit ambientalist dhe social nga çdo kontraktues të përfshirë në projekt dhe një përmbledhje të çdo mospërputhshmërie thelbësore nga ky kontraktues me kërkesat e parashikuara të efektshmërisë dhe planit të veprimit ambientalist dhe social dhe të çdo mase të marrë për të korrigjuar këtë mospërputhje;

3. Informacion mbi zbatimin e planit të përfshirjes së aktorëve që kërkohet nga kërkesa e parashikuar e efektshmërisë 10, duke përfshirë një përmbledhje të çdo ankese që paraqitet dhe si këto ankesa janë zgjidhur;

4. Informacion mbi përputhshmërinë e Huamarrësit me ligjet ambientaliste dhe sociale në lidhje me projektin, duke përfshirë statusin e çdo autorizimi të kërkuar për projektin, rezultatet e çdo inspektimi të kryer nga një autoritet rregullator, çdo shkelje të ligjeve, rregulloreve ose standardeve të zbatueshme dhe çdo veprimi korrigjuues ose gjobe në lidhje me këtë shkelje, dhe një përmbledhje të çdo njoftimi të rëndësishëm, raporti dhe komunikimi tjetër mbi çështjet ambientaliste dhe sociale në lidhje me projektin e paraqitur nga Huamarrësi te çdo autoritet rregullator;

5. Informacion mbi menaxhimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe regjistrin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të projektit, duke përfshirë shpeshësinë e aksidenteve, incidentet me pasojë humbje kohe dhe rreziqet, çdo masë parandaluese ose lehtësuese të marrë ose planifikuar nga Huamarrësi, çdo trajnim personeli për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe çdo iniciativë tjetër në lidhje me menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë që është zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

6. Një përmbledhje të çdo ndryshimi në ligjet ambientaliste dhe sociale që mund të kenë një efekt thelbësor për projektin; dhe

7. Kopje të çdo informacioni mbi çështjet ambientaliste dhe sociale që i paraqiten periodikisht nga Huamarrësi publikut të gjerë.

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, FZSHH-ja, në emër të Huamarrësit, i paraqet Bankës raporte periodike për projektin e përmendur në seksionin 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde çdo tremujor, brenda 45 ditëve pas fundit të periudhës së raportimit, derisa të jetë përfunduar projekti. Këto raporte përfshijnë detajet e mëposhtme specifike:

1. Informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

A) Progresi fizik i bërë në zbatimin e projektit deri në datën e raportit gjatë periudhës së raportimit;

B) Vështirësitë aktuale ose të pritshme, ose vonesat në zbatimin e projektit dhe efekti i tyre në grafikun e zbatimit, dhe hapat faktikë të ndërmarrë ose të planifikuar për të kaluar vështirësitë dhe mënjanuar vonesat;

C) Ndryshime të pritshme në datën e përfundimit të projektit;

D) Ndryshimet thelbësore të personelit të konsulentëve ose të kontraktorëve;

E) Çështjet që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe

F) Çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në realizueshmërinë ekonomike të ndonjë pjese të projektit.

2. Një tabelë progresi, bazuar mbi grafikun e zbatimit të projektit, që tregon progresin në çdo pjesë të projektit dhe duke përfshirë një grafik të planifikuar dhe faktik të shpenzimeve.

3. Pasqyrat financiare që tregojnë hollësitë e shpenzimeve të shkaktuara në çdo pjesë të projektit dhe tërheqjet, së bashku me një deklaram që tregon:

A) vlerësimet fillestare të shpenzimeve;

B) vlerësimet e rishikuara të shpenzimeve, nëse ka, me shkaqet e ndryshimeve;

C) shpenzimet fillestare të vlerësuara dhe shpenzimet faktike deri tani;

D) shkaqet për ndryshimet e shpenzimeve faktike deri tani nga shpenzimet fillestare të vlerësuara deri tani; dhe

E) shpenzimet e vlerësuara për tremujorët e mbetur të vitit.

4. Një deklaram të shkurtër të statusit të përputhshmërisë me secilin kusht që gjendet në këtë Marrëveshje.

c) Menjëherë pas ndodhës së një incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin ose projektin që ka ose mund të ketë efekt negativ të konsiderueshëm mbi ambient ose mbi shëndetin, ose sigurinë publike, ose në punë, Huamarrësi informon Bankën dhe menjëherë pas kësaj i bën njoftim Bankës për këtë, duke specifikuar natyrën e këtij incidenti ose aksidenti dhe çdo hapi që Huamarrësi po ndërmerr për të korrigjuar këtë. Pa kufizuar përgjithësimin e sa më sipër:

1. një incident ose aksident ka të bëjë me projektin nëse ai ndodh në një vend që përdoret për projektin ose nëse shkaktohet nga impiantet, pajisjet, automjetet ose mjetet e lundrimit që përdoren ose kanë të bëjnë me projektin (që përdoren ose jo në një vend të projektit dhe pavarësisht nëse përdoren apo jo nga personat e autorizuar ose të paautorizuar);

2. një incident ose aksident konsiderohet të ketë efekt të konsiderueshëm negativ mbi ambientin ose mbi shëndetin, ose sigurinë publike, ose të punës, nëse:

A) çdo ligj i zbatueshëm kërkon njoftimin e këtij incidenti ose aksidenti te një autoritet qeveritar;

B) një incident ose aksident i tillë ka të bëjë me fatalitetin e një personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar nga Huamarrësi);

C) më shumë se një person (pavarësisht nëse këta persona janë të punësuar nga Huamarrësi) ka pësuar plagosje të rëndë që kërkon shtrim në spital; ose

D) një incident ose aksident i tillë është bërë ose mund të bëhet publikisht i njohur qoftë nëpërmjet mbulimit të medias apo ndryshe.

d) Të paktën një herë në vit dhe në çdo rast jo më vonë se fundi i vitit fiskal, FZSHH-ja në emër të Huamarrësit i jep Bankës një listë të seksioneve të rrugëve lokale dhe rajonale, rehabilitimi i të cilave parashikohet në këtë Marrëveshje dhe është planifikuar të kryhet vitin në vazhdim. Kjo listë është në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe Banka pranon secilin dhe të gjithë zërat e përcaktuara në këtë listë.

#### Neni 4

#### **Kushte financiare**

##### Seksioni 4.01 Regjistrat dhe raportet financiare

a) Në lidhje me departamentet ose agjencitë e Huamarrësit, përgjegjëse për zbatimin e projektit ose një pjese të tij, Huamarrësi do të mbajë procedura, regjistra dhe llogari që reflektojnë në mënyrë të përshtatshme, në pajtim me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht, të aplikuara njëtrajtësisht, operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin dhe për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë shpenzimet e tij dhe përfitimet që rrjedhin prej tij).

b) Huamarrësi:

1. duhet të ketë regjistra dhe llogari të përmendura në seksionin 4.01(a), duke përfshirë ato në lidhje me llogarinë e veçantë, për çdo vit fiskal të audituar nga auditë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në pajtim me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht;

2. duhet t'i paraqesë Bankës, sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të çdo viti fiskal, raportin e këtij auditimi nga këta auditë me atë objekt dhe hollësi që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka; dhe

3. duhet t'i japë Bankës çdo informacion tjetër në lidhje me regjistra dhe llogari, dhe auditimin e tyre, që mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme herë pas here.

#### Neni 5

#### **Pezullimi, përshpejtimi, anulimi**

##### Seksioni 5.01 Pezullimi

Sa më poshtë përcaktohet për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e rrugëve në territorin e Huamarrësit të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë në një mënyrë tjetër prej asaj të aprovuar nga Banka me shkrim; ose

b) e drejta e Huamarrësit për të tërhequr në bazë të kontratës së financimit me EIB ose për të tërhequr nga fondet e grandit të IPA-s të jetë pezulluar, anuluar ose pushuar plotësisht ose pjesërisht, në pajtim me termat e angazhimeve përkatëse, megjithatë, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos zbatohen nëse Huamarrësi provon në mënyrë të pranueshme për Bankën që grande ose hua koncesionare të mjaftueshme për të dhënë fonde të mjaftueshme për projektin janë në dispozicion të Huamarrësit nga burime të tjera me terma dhe kushte në pajtim me detyrimet e Huamarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i maturimit

Sa më poshtë përcaktohet, për qëllimet e seksionit 7.06(f) të termave dhe kushteve standarde:

a) çdo ngjarje e specifikuar në seksionin 5.01 që ka vazhduar për tridhjetë ditë pasi t'i jetë bërë njoftimi Huamarrësit nga Banka për përcaktimin e Bankës që kjo ngjarje ka ndodhur, duke cituar gatishmërinë e Bankës për të vepruar në pajtim me seksionin 7.06 të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 5.03 Anulimi

Nëse në një moment Banka përcakton që një pagesë ose një përdorim i llogarisë së veçantë është bërë në mënyrë që nuk përputhet me kërkesat e skedulit 3 dhe përcakton shumën e huasë për të cilën vlen ky keqpërdorim, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të pushojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje në lidhje me këtë shumë. Me dhënien e këtij njoftimi, kjo shumë e huasë anulohet.

## Neni 6

### Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01 Kushtet paraprake të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe disbursimi i transhit

A

Sa më poshtë përcaktohen, për qëllimet e seksionit 9.02(c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje dhe kushte para disbursimit të transhit A të huasë:

a) kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar;

b) ligji për ngritjen e Autoritetit Shqiptar të Rrugëve është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar;

c) Banka bindet që zbatimi i kërkesave të parashikuara në planin e veprimit ambientalist dhe social po vazhdon kryesisht në pajtim me grafikun që gjendet në veprimin ambientalist dhe social dhe që, bazuar në progresin e deritanishëm, kërkesat e parashikuara në planin e veprimit ambientalist dhe social priten të përmbushen brenda afatit të parashikuar në këtë plan;

d) lista e seksioneve rrugore, rajonale dhe lokale, rehabilitimi i të cilave parashikohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe planifikohet të kryhet gjatë vitit të parë pas datës së disbursimit të parë sipas transhit A, i është dhënë Bankës në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe Banka është dakord me secilin dhe të gjithë zërat që janë përfshirë në këtë listë;

e) konsulentët e kualifikuar për të mbështetur FZSHH-në në zbatimin e projektit, duke përfshirë konsulentët e mbikëqyrjes inxhinierike të pranueshëm për Bankën janë emëruar; dhe

f) kontrata e financimit EIB është nënshkruar dhe dorëzuar, dhe të gjitha kushtet paraprake për hyrjen në fuqi të saj ose të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas saj, përveç hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur.

Seksioni 6.02 Opinioni ligjor

Për qëllimet e seksionit 9.03(a) të termave dhe kushteve standarde, mendimi ose mendimet e këshilltarit ligjor janë dhënë në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

Seksioni 6.03 Kushtet për çeljen e transhit B

Pa cenuar diskrecionin e Bankës për të përcaktuar nëse duhet bërë apo jo ndonjë disbursim në bazë të transhit B, detyrimi i Bankës për të bërë disbursimin e parë të transhit B i nënshtrohet përmbushjes së kushteve, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që në datën e kërkesës së Huamarrësit për këtë disbursim të transhit B dhe në datën e këtij disbursimi:

a) fondet IPA 2010 dhe IPA 2011 në shumën e përgjithshme 33 000 000 euro janë të disponueshme; dhe

b) Autoriteti Shqiptar i Rrugëve është ngritur dhe është funksional, dhe është i përgjegjshëm për administrimin e rrjetit rajonal të rrugëve që mbulohen nga projekti.

Seksioni 6.04 Prishja për shkak të moshyrjes në fuqi

Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

#### Neni 7

#### **Të ndryshme**

Seksioni 7.01 Njoftime

Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bul. "Dëshmorët e Kombit", 1

Tiranë

Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Faks: (355) (4) 2228 494

Për Bankën:

European Bank for Reconstruction and Development

One Exchange Square

London EC2A 2JN

United Kingdom

Në vëmendje të: Operation Administration Unit

Faks: +44-20-7338-6100

Në dëshmi sa më sipër, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullit, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në katër kopje dhe dorëzimin në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e shkruar së pari më sipër.

#### SKEDULI 1

#### PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është asistimi i Huamarrësit në rehabilitimin e deri 500 km rrjet rrugor rajonal dhe lokal në Shqipëri.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, në pajtim me ato modifikime që Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Përgatitja e projekteve inxhinierike

Pjesa B: Punët civile për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale

Punët për pjesën B të projektit, duke përjashtuar tatimet, do të bashkëfinancohen nga grandet EIB dhe IPA 2010 dhe IPA 2011. Huamarrësi financon çdo marrje në pronësi të tokës dhe të gjitha tatimet në lidhje me pjesën B të projektit (duke përfshirë në lidhje me kontratat e punëve civile).

Pjesa C: Mbikëqyrja e punëve të ndërtimit për projektin e përmendur në pjesën B, menjëherë sapo të skadojë kontrata mbi mbikëqyrjen tashmë në fuqi ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës Botërore, që do të financohet nga grandet WBIF TC.

Emërohet një konsulent mbikëqyrjeje që do të monitorojë zbatimin e punëve sipas pjesës B të projektit.

Pjesa D: Monitoruesi i Huadhënësit

Emërohet një monitorues i Huadhënësit që monitoron zbatimin e projektit në emër të bankave.

Pjesa E: Mbështetja në zbatim

Emërohet një konsulent që jep mbështetje për zbatimin për FZSHSH-në, dhe

Pjesa F: Konsulentët për përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale

Emërohen konsulentë për të asistuar FZSHSH-në në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale.

Shërbimet sipas pjesëve A, D, E, dhe F financohen nga grandet WBIF TC.  
3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2015.

## SKEDULI 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur këtij skeduli përcakton kategoritë, shumën e huasë së alokuar për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohet për çdo kategori.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të mësipërm, asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra para datës së Marrëveshjes së huasë.

### Shtojcë e skedulit 2

Kategoria	Shuma e huasë së alokuar në monedhën e huasë	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohet
1. Punët për pjesën B të projektit	49 500 000 euro	37.2%, duke përjashtuar çdo tatim*
2. Komisioni i fillimit	500 000 euro	100%
<b>Totali</b>	<b>50 000 000 euro</b>	

\* përqindja e financimit të përgjithshëm të projektit.

## SKEDULI 3 LLOGARIA E VEÇANTË

1. Për qëllimet e këtij skeduli, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"Kategori e përshtatshme" janë kategoritë 1 dhe 2 të shtojcës së skedulit 2.

"Shpenzime të përshtatshme" janë shpenzimet në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve që kërkohen për projektin që duhet të financohen nga shumat e huasë dhe që alokohen herë pas here te një kategori e përshtatshme, në pajtim me dispozitat e skedulit 2.

"Balanca maksimale e llogarisë së veçantë" është një shumë e barabartë me 5 000 000 euro;

"Shuma minimale e tërheqjes nga llogaria e veçantë" është një shumë e barabartë me 250 000 euro.

2. Pagesat nga llogaria e veçantë bëhen vetëm për shpenzime të përshtatshme në pajtim me dispozitat e këtij skeduli.

3. Pasi Banka merr prova të pranueshme prej saj që llogaria e veçantë është hapur rregullisht në pajtim me termat dhe kushtet e pranueshme për Bankën, duke përfshirë mbrojtjen e përshtatshme ndaj kompensimit, sekuestrimit dhe konfiskimit, Huamarrësi mund të tërheqë nga shumat e disponueshme dhe të depozitohet në llogarinë e veçantë një shumë fillestare që nuk kalon balancën maksimale të llogarisë së veçantë dhe nuk është më e vogël se shumta minimale e tërheqjes nga llogaria e veçantë.

4. Pas kësaj, Huamarrësi mund të tërheqë shumta shtesë nga shumta e disponueshme dhe t'i depozitohet këto shumta në llogarinë e veçantë, në pajtim me kufizimet e përcaktuara në paragrafin 6 të mëposhtëm dhe përmbushjen e kushteve të mëposhtme për secilën tërheqje të kërkuar:

a) Huamarrësi i ka paraqitur Bankës pasqyra llogarish dhe dokumente, dhe çdo provë tjetër të kërkuar nga Banka për të demonstruar që shumtat e disbursuara nga llogaria e veçantë janë aplikuar rregullisht.

b) Pas dhënies fuqi të tërheqjes së kërkuar dhe depozitimit të shumës së kësaj tërheqjeje në llogarinë e veçantë, balanca e llogarisë së veçantë nuk kalon balancën maksimale të llogarisë së veçantë.

c) Përveç kur Banka bie dakord herë pas here, shumta e tërheqjes së kërkuar për depozitim në llogarinë e veçantë nuk është më e vogël se shumta minimale e tërheqjes nga llogaria e veçantë.

5. Pa cenuar kërkesat e paragrafit 4(a) më sipër, Huamarrësi, në çdo moment që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, paraqet një raport mbi balancën dhe hollësi të tjera të llogarisë së veçantë, duke përfshirë pasqyra llogarish dhe dokumente dhe prova të tjera që Banka mund të kërkojë, të



cilat tregojnë që pagesat e bëra nga llogaria e veçantë janë bërë në pajtim me kërkesat e parashikuara në këtë skedul.

6. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 4 të këtij skeduli, Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, tërheq fonde nga llogaria e vënë në dispozicion për depozitim në llogarinë e veçantë:

a) nëse, në çdo kohë, Banka përcakton që të gjitha tërheqjet e tjera duhet të bëhen në pajtim me dispozitat e seksionit 2.03(a); ose

b) menjëherë sapo shuma e disponueshme e alokuar në kategoritë e përshtatshme është e barabartë me dyfishin e shumës së balancës maksimale të llogarisë së veçantë.

Pas kësaj, tërheqjet e alokuara te kategoritë e përshtatshme ndjekin ato procedura që Banka mund të përcaktojë me një njoftim drejtuar Huamarrësit. Këto tërheqje të tjera bëhen vetëm pas dhe në masën që Banka është bindur që shumat e mbetura në depozitën e llogarisë së veçantë në datën e këtij njoftimi do të përdoren për bërjen e pagesave për shpenzime të përshtatshme.

7. Nëse Banka përcakton në çdo kohë që një pagesë ose një përdorim i llogarisë së veçantë:

a) është bërë për një shpenzim ose në një shumë që nuk është e përshtatshme në pajtim me paragrafin 2 të këtij skeduli; dhe

b) nuk është bindur nga provat e paraqitura Bankës;

atëherë Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit:

1. të paraqesë ato prova shtesë që mund të kërkojë Banka; dhe/ose;

2. të depozitojë në llogarinë e veçantë (ose, nëse Banka e kërkon këtë, i shlyen Bankës) një shumë të barabartë me shumën e këtyre pagesave ose pjesën e tyre që nuk është e përshtatshme ose nuk justifikohet.

Në rast se Banka bën një përcaktim të tillë në bazë të (a) ose (b) më sipër, nuk bëhet asnjë tërheqje, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, për depozitën në llogarinë e veçantë deri në atë moment kur Huamarrësi të ketë: (A) depozituar në llogarinë e veçantë ose shlyer Bankës një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese (ose një pjesë të saj) të përcaktuar të papërshtatshme ose të pajustificuar, ose (B) i ka paraqitur Bankës prova shtesë të pranueshme për të që shumat e disbursuara më parë nga llogaria e veçantë janë zbatuar rregullisht.

8. Nëse:

a) Banka përcakton në një moment të caktuar që një shumë e mbetur në llogarinë e veçantë nuk do të kërkohej për të mbuluar pagesat e mëtejshme për shpenzimet e përshtatshme; ose

b) Banka udhëzon Huamarrësin t'i shlyejë Bankës një shumë në pajtim me paragrafin 7(2);

Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Bankës, i parapaguan Bankës një pjesë të huasë së barabartë me këtë shumë. Për këtë qëllim, hiqet dorë nga kërkesa që parapagesat e huasë duhet të bëhen në datat e pagesës së interesit, sipas paragrafit 10 më poshtë.

9. Huamarrësi, me njoftim paraprak drejtuar Bankës të dhënë në pajtim me seksionin 3.07(a) të termave dhe kushteve standarde, mund të parapaguajë në çdo datë të pagesës së interesit të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në llogarinë e veçantë.

10. Çdo parapagesë, në pajtim me paragrafin 8 ose 9 më sipër, bëhet në pajtim me seksionin 3.07 të termave dhe kushteve standarde; megjithatë, me kusht që: (a) pavarësisht seksionit 3.07(c)(i)(A) të termave dhe kushteve standarde, kjo parapagesë nuk i nënshtrohet shumës së parapagesës minimale, dhe (b) çdo parapagesë që bëhet në një datë të ndryshme nga data e pagesës së interesit i nënshtrohet pagesës së kostos së ndryshuar, në pajtim me seksionin 3.10 të termave dhe kushteve standarde. Çdo parapagesë në pajtim me paragrafin 8 ose 9 të mësipërm aplikohet nga Banka në pajtim me seksionin 3.07(c)(ii) të termave dhe kushteve standarde.

SKEDULI 4  
PLANI PËR MENAXHIMIN SOCIAL DHE TË AMBIENTIT

Nr.	Çështja	Masa/veprimi zbutës	Pala përgjegjëse	Afati kohor
1	Dokumentacioni i zbatueshëm	Rishikimi i kuadrit të garancive për ambientin (ESE) dhe kuadrit të politikave të rivendosjes (RPF) që janë përgatitur nga Banka Botërore (BB) për të përfshirë procedurat dhe udhëzimet për ndonjë kërkesë që mungon të EBRD-së	EBRD TC	Para vlerësimit të fillimit të nënprojektit individual
2	Trajnimi	Trajnimi i shoqërisë projektuese për të respektuar kërkesat e parashikuara në ESF, RPF, dhe EBRD PR-ve	ADF dhe EBRD TC	Para vlerësimit për fillimin e nënprojekteve individuale
3.	Burimet	Vlerësimi i përshtatshmërisë së burimeve sociale dhe ambientaliste të ADF-së për të menaxhuar ngarkesën e punës; këshillime nëse ADF-ja kërkon burime shtesë; dhe trajnimi i ADF-së për EBRD PR-të	EBRD TC	Para vlerësimit për fillimin e nënprojekteve individuale
4	Burimet	Nëse burimet e ambientit dhe sociale të ADF-së konstatohen të pamjaftueshme për të përballuar ngarkesën e punës, punësimi i personit shtesë që mendohet i nevojshëm nga EBRD-ja.	ADF	Para vlerësimit për fillimin e nënprojekteve individuale
5.	Standardet e zbatueshme	Menaxhimi i çështjeve ambientaliste, sociale, të shëndetit dhe sigurisë së projektit në një mënyrë që është në pajtim me praktikën e mirë kombëtare dhe ndërkombëtare (si të Bankës Botërore I/FC-së) dhe politikat sociale dhe Politikë të EBRD-së dhe kërkesat e performancës (2008)	ADF	Të gjitha fazat
6.	Dokumentacioni i zbatueshëm	Zbatimi i procedurave të kujdesit të duhur të përkufizuara sipas ESF-së dhe RPF-së së rishikuar	ADF	Të gjitha fazat
7	Dokumentacioni i zbatueshëm	Para fillimit të punëve, shtjellimi i planeve të menaxhimit dhe monitorimit ambientalist, planeve të menaxhimit dhe monitorimit social për çdo seksion të rrugës së financuar nga EBRD-ja në mënyrë të pranueshme për EBRD-në dhe Huamarrësin, në pajtim me kërkesat e parashikuara në ref.6 të kësaj ESAP, ESF-je dhe RPF-je	ADF	Të gjitha fazat
8	Dokumentacioni i zbatueshëm	Huamarrësi zbaton të gjitha planet ambientaliste, sociale, të shëndetit dhe sigurisë (EHSS) (sipas përcaktimit në ref.7 të këtij ESAP) duke përfshirë ESAP-in, masat dhe lejon kushtet e përmendura në ESF	ADF	Të gjitha fazat
9	Projekt	Planet e rehabilitimit të rrugës duhet të përfshijnë masat për sigurinë e rrugës dhe sinjalistikën në pajtim me legjislacionin e brendshëm dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare.	ADF	Projekt
10	Ndërtim	Zbatimi i kujdesshëm i procedurave dhe planet e veprimit të përmendura në ref.6-8 përbëjnë pjesë të kontratës së kontraktorit të ndërtimit.	Ndërtuesi	Para operacioneve

11	Ndërtim	Të gjithë ndryshimet në planet dhe procedurat e detajuara në ref.6-8 të kësaj ESAP-i miratohen nga EBRD-ja dhe Huamarrësi para zbatimit.	ADF	Para zbatimit
12	Menaxhimi i kontraktorëve të ndërtimit	<p>Huamarrësi informon kontraktorët për përgjegjësitë e tyre ambientaliste dhe sociale, duke përfshirë kërkesat brenda kësaj ESAP-i. Kërkesat e zbatueshme sociale dhe të ambientit përcaktohen në marrëveshjet kontraktuale dhe monitorohen.</p> <p>Huamarrësi do të menaxhojë kontraktorët për të siguruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune, duke nxitur praktikat më të mira shëndetësore dhe të sigurisë në vendin e punës dhe siguron garantimin e pajisjeve mbrojtëse të personelit dhe zbatimin e përdorimit të tyre.</p> <p>Huamarrësi do të veprojë si një punonjës i përgjegjshëm ndaj personelit dhe kontraktorëve. Ai garanton gjithashtu që kontraktorët të zbatojnë të njëjtat standarde dhe ata ose kontraktorët e tyre të japin: paga të drejta, orë pune të arsyeshme, pajisje dhe masa sigurie dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin e brendshëm dhe kërkesat e ILO-s dhe ekzistencën e një procedure ankimi për punëtorët.</p>	ADF	Të gjitha fazat
13	Angazhimi i aktorëve & njoftimet publike	<p>Huamarrësi zbaton procedura për konsultime publike dhe angazhimin e aktorëve që përmbushin kërkesat e EBRD-së për konsultim dhe deklarim publik.</p> <p>Huamarrësi shpërndan informacion në kohë para fillimit të punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për të informuar komunitetet e interesuara në lidhje me çdo aktivitet ndërtimi që mund t'i prekë ata (pengesa trafiku dhe kalimi, zhurmë, pluhur);</li> <li>- për të informuar komunitetet e interesuara në lidhje me ecurinë e punimeve;</li> <li>- për të kërkuar komente nga anëtarët e komunitetit në lidhje me efikasitetin e masave zbutëse për shqetësimet e shkaktuara nga ndërtimi; dhe</li> <li>- për disponibilitetin e procedurave të ankimit;</li> <li>- për komunikimin e rezultateve të monitorimit ambientalist (kryesisht zhurma dhe cilësia e ajrit) për publikun.</li> </ul>	ADF	Të gjitha fazat

14	Procedura e ankimit nga punëtorët	Një procedurë normale për ankesat e punëtorëve do të vendoset nga Huamarrësi për gjithë kohëzgjatjen e projektit.	ADF	Para ndërtimit Të gjitha fazat
15	Raportet mujore gjatë ndërtimit	<p>Sapo të jetë e disponueshme, por në çdo rast brenda (5) ditëve të punës pas paraqitjes së raportit mujor të punëve tek autoriteti publik, paraqitet një kopje elektronike e këtij raporti te konsulenti i monitorimit të EBRD-së që mbulon: i) një raport sigurie dhe ambienti, që jep hollësi për aksidentet në vendndodhje, normat aktuale të aksidenteve dhe masat parandaluese që janë vendosur për të parandaluar ose ulur aksidentet, dhe ii) çdo ngjarje e dukshme, duke përfshirë ngjarjet në lidhje me komunitetin, ambientin dhe median.</p> <p>Sapo të jetë e disponueshme, por në çdo rast brenda (10) ditëve të punës pas marrjes së raportit të progresit të inxhinierit të pavarur, paraqet një kopje elektronike të këtij raporti (seksionet në lidhje me çështjet e ambientit dhe sociale) për konsulentin e monitorimit të EBRD-së.</p>	ADF	Çdo muaj gjatë ndërtimit
16	Raportet vjetore	<p>Huamarrësi do t'i japë EBRD-së një raport përputhshmërie të ESAP, që përmbledh raportet e operacioneve/ndërtimeve mujore, dhe përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. informacion mbi përputhshmërinë me standardet ambientaliste, shëndetësore, sociale dhe të sigurisë, duke përfshirë statusin e çdo autorizimi të kërkuar për projektin, rezultatet e çdo inspektimi të bërë nga një autoritet rregullator dhe shkeljen e ligjeve, rregulloreve ose standardeve të zbatueshme dhe çdo veprim korrigjues apo gjobë në lidhje me këtë shkelje.</li> <li>2. informacion mbi zbatimin e planeve dhe procedurave të përmendura në ref.6 (të këtij ESAP-i), duke përfshirë çdo ndryshim të propozuar për veprimet, skedulët dhe koston.</li> <li>3. informacion mbi zbatimin e kërkesave të kuadrit të së drejtës, rivendosjes dhe kompensimit gjatë periudhës së ndërtimit dhe vitit të parë të funksionimit.</li> <li>4. një përmbledhje të çdo njoftimi material, raporti apo komunikimi tjetër për çështjet HSES për çdo autoritet rregullator.</li> <li>5. informacion mbi të dhënat shëndetësore dhe të sigurisë së projektit, duke përfshirë normën e aksidenteve dhe çdo iniciativë në lidhje me çështjet e shëndetit dhe sigurisë që janë zbatuar apo planifikuar nga Huamarrësi.</li> </ol>	ADF	Çdo vit Të gjitha fazat

		6. një përmbledhje të çdo ndryshimi në ligjet në lidhje me çështjet HSES që mund të kenë efekt material mbi projektin, dhe		
		7. kopje të çdo informacioni për çështjet HSES që u jepen periodikisht aktorëve ose publikut të gjerë.		

**LIGJ**  
**Nr.10 270, datë 22.4.2010**

**PËR TË DREJTËN E PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT SHTETËROR NË PËRDORIM DHE PËR TAKSËN MBI TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti i ligjit**

Objekt i këtij ligji është rregullimi dhe sigurimi i mbledhjes së të ardhurave nëpërmjet të drejtës së privatizimit dhe vendosjes së taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror në përdorim të individëve, që kanë përfituar nga procesi i privatizimit të ndërtimeve mbi truallin shtetëror, sipas parashikimeve të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 2  
**Fusha e zbatimit të ligjit**

1. Ky ligj zbatohet për:

a) trojet e paprivatizuara, të ndërtesave të privatizuara nga shtetasit me ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas gjenplaneve në momentin e privatizimit të ndërtesave;

b) trojet e paprivatizuara të ndërtesave të shitura nga ndërmarrjet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas gjenplaneve në momentin e shitjes së ndërtesave;

c) trojet e paprivatizuara, mbi të cilat janë ndërtuar ndërtesa, mbi bazën e lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga komitetet pluraliste të këshillave, në periudhën e funksionimit të tyre, sipas gjenplaneve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit;

ç) trojet në përdorim të personave juridikë tregtarë, në përputhje me parashikimet e vendosura nga ligji i veçantë.

2. Ky ligj nuk e shtrin veprimin e vet mbi trojet turistike, mbi objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo mbi trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera.

**KREU II**  
**ZBATIMI I LIGJIT DHE E DREJTA PËR PRIVATIZIM PËR TRUALLIN NË PËRDORIM**

Neni 3

**Subjektet që i nënshtrohen taksimit për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror**

Detyrimin për pagesën e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror e kanë:

- a) individët që kanë në përdorim trojet e paprivatizuara të ndërtesave të përshkruara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji;
- b) personat juridikë tregtarë dhe ndërmarrjet shtetërore, sipas parashikimit të ligjit të veçantë;
- c) personat juridikë tregtarë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me një akt juridik të vlefshëm, përfitojnë të drejtën e përdorimit të trojeve shtetërore.

Neni 4

**Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror**

1. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është taksë vjetore.
2. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është 10 për qind e vlerës së truallit shtetëror në përdorim.

Neni 5

**Llogaritja e vlerës së truallit në përdorim**

Për llogaritjen e vlerës së truallit, në vite të ndryshme, shërben harta përkatëse e vlerës së trojeve, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës.

Neni 6

**Përlllogaritja dhe pagesa e taksës**

1. Në rast se trualli privatizohet nëpërmjet blerjes së truallit në përdorim, atëherë përlllogaritja e taksës bëhet proporcionalisht vetëm për periudhën e vitit, gjatë të cilit është ushtruar e drejta e përdorimit të truallit shtetëror.
2. Përlllogaritja e taksës bëhet duke shumëzuar nivelin e taksës me vlerën e truallit shtetëror në përdorim.
3. Për përlllogaritjen dhe vjeljen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore.

Neni 7

**Mënyra e pagesës së taksës**

1. Brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës, subjektet, që i nënshtrohen taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, dorëzojnë, në drejtoritë rajonale ku janë të regjistruar apo në territorin e të cilave banojnë, formularin e deklarimit të taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.
2. Formulari i deklarimit miratohet me urdhër të Ministrit të Financave.
3. Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror paguhet në bankë, për llogari të organeve tatimore.

Neni 8

**Detyrimi për raportimin e të dhënave mbi truallin në përdorim  
pranë administratës tatimore qendrore**

1. Detyrimin për raportimin e të dhënave mbi truallin në përdorim e kanë:
  - a) individët, që kanë në përdorim trojet e paprivatizuara të ndërtesave të përshkruara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji;

b) personat juridikë tregtarë, si dhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë në përdorim truall shtetëror, pavarësisht nga lloji i kontratës apo marrëveshjes, në bazë të së cilës i gëzojnë të drejtat e përdorimit;

c) personat juridikë tregtarë që marrin në përdorim truallin shtetëror, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht nga lloji i kontratës.

Kjo pikë nuk e shtrin efektin e vet për subjektet e përjashtuara në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Subjektet që kanë detyrimin për raportim të të dhënave mbi truallin në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, raportojnë në drejtoritë rajonale tatimore të dhënat për truallin në përdorim, sipërfaqen, vendndodhjen, si dhe aktin, në bazë të së cilit e gëzojnë të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

3. Administrata tatimore qendrore, për të saktësuar rastet që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, mund të kërkojë informacione shtesë në lidhje me truallin apo të dhëna të tjera që i nevojiten.

#### Neni 9

### **E drejta e privatizimit të truallit në përdorim për individët**

1. Individët që preken nga fusha e zbatimit të këtij ligji kanë të drejtën e privatizimit, nëpërmjet blerjes së truallit shtetëror, nën ndërtesën e privatizuar, të blerë apo të ndërtuar prej tyre.

2. Kontrata e privatizimit, nëpërmjet blerjes, nënshkruhet nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pranë Ministrisë së Financave dhe individit, që ka qenë përdorues i truallit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kopje e kontratës i dërgohet, për dijeni, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

#### Neni 10

### **E drejta e blerjes së truallit në përdorim për personat juridikë, shoqëri tregtare**

1. Shoqëritë tregtare kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e blerjes së truallit apo pjesë të truallit, sipas parashikimeve të bëra nga ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

2. Kushtet dhe masa e përfitimit nga e drejta e privatizimit të truallit shtetëror apo pjesë të tij, në përdorim të personit juridik tregtar, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 11

### **Marrëveshja e pagesës me këste**

1. Nëse individit, që kërkon të privatizojë truallin shtetëror, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ndodhet përpara pamundësisë për të paguar menjëherë, mund të kërkojë lidhjen e një marrëveshjeje për pagesë me këste.

2. Kërkesa bëhet me shkrim dhe depozitohet pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Në kërkesë duhet të shprehet vullneti për blerjen e truallit të ofruar për shitje, si dhe vërtetimi që ka paguar rregullisht taksën e të drejtës së përdorimit të truallit shtetëror.

3. Marrëveshja e pagesës me këste lidhet me Drejtorin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave.

#### Neni 12

### **Afati maksimal i lidhjes së marrëveshjes së pagesës me këste**

1. Në çdo rast, kohëzgjatja e marrëveshjes së pagesës me këste nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj.

2. Në rast të mosrespektimit të afatit të pagesës edhe të një kësti të vetëm, marrëveshja zgjidhet dhe shumata e paguara deri në atë çast shkojnë për llogari të shlyerjes së taksës së të drejtës së përdorimit të truallit shtetëror. Për këtë qëllim, bëhet transferta përkatëse në llogarinë e administratës tatimore.

Neni 13

**Pagesa e taksës gjatë marrëveshjes së pagesës me këste**

Ekzekutimi i marrëveshjes së pagesës me këste nuk pezullon pagesën e plotë të taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

Neni 14

**Përfundimi i detyrimit për pagesën e qirasë**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, individët që i nënshtrohen taksimit për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, nuk kanë më detyrimin për të paguar qira për truallin në përdorim.

Neni 15

**Falja e qirave të papaguara**

1. Qiratë e papaguara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, falen, në rastet kur individët, që përfshihen në subjektet që i nënshtrohen detyrimit për pagesën e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji:

- a) depozitojnë kërkesën për privatizim dhe pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit;
- b) nënshkruajnë marrëveshje për pagesën me këste.

2. Heqja dorë nga kërkesa për pagesë të menjëhershme apo nga marrëveshja e pagesës me këste, si dhe mosrespektimi i afatit të pagesës, qoftë edhe të një kësti të vetëm në rastin e marrëveshjes së pagesës me këste, rikthen detyrimin për pagesën e qirave të papaguara.

Neni 16

**Të ardhurat nga procesi i privatizimit apo shitjes së truallit shtetëror**

Të ardhurat e mbledhura nga procesi i privatizimit apo i shitjes së truallit shtetëror, të kryer në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kalojnë 75 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 25 për qind në buxhetin e pushtetit vendor.

Neni 17

**Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet**

1. Plotësimi në mënyrë të pasaktë i formularit të deklarimit, mosdorëzimi në kohë i formularit të deklarimit të taksës, apo mospagesa në kohë e detyrimit për taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Administratorët e personave juridikë, tregtarë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore që, sipas nenit 8 të këtij ligji, kanë detyrimin për raportimin e të dhënave mbi truallin në përdorim dhe nuk dorëzojnë raportin përkatës pranë administratës tatimore, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dënohen me gjobë në masën e një page mujore. Organi administrativ, që nxjerr vendimin për kundërvajtjen administrative, në këtë rast, është ministri i linjës, nga i cili varet personi juridik tregtar apo ndërmarrja shtetërore.

3. Administratorët e personave juridikë, tregtarë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore, të cilët nuk i japin menjëherë apo refuzojnë t'i japin administratës tatimore qendrore informacionet shtesë të kërkuara prej saj, dënohen me gjobë në masën e një page mujore. Organi administrativ që nxjerr vendimin për kundërvajtjen administrative, në këtë rast, është ministri i linjës, nga i cili varet personi juridik tregtar apo ndërmarrja shtetërore.



KREU III  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

**Lehtësitë për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit**

1. Individët, që përfitojnë nga e drejta e privatizimit të truallit shtetëror, sipas parashikimeve të këtij ligji, mund të kërkojnë, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, privatizimin e truallit me shlyerje të menjëhershme të pagesës.

2. Nëse kërkesa për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, i cili kërkohet të privatizohet, bëhet me shkrim, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe kjo pagesë realizohet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me autorizim për kalim pronësie trualli, individët përfitojnë një ulje prej 20 për qind të vlerës dhe 20 për qind të vlerës së mbetur mund të paguhet me bono privatizimi.

3. Nëse kërkesa për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, i cili kërkohet të privatizohet, bëhet me shkrim, pas gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe kjo pagesë realizohet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me autorizim për kalim pronësie trualli, individët përfitojnë një ulje prej 20 për qind të vlerës.

Nuk përfitojnë nga ky përjashtim individët, të cilët e paraqesin kërkesën e tyre pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 19

**Pezullimi i detyrimit për pagesë të menjëhershme**

1. Në çastin e bërjes së kërkesës për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, sipas dispozitave të nenit 18 të këtij ligji, pezullohet detyrimi për pagesën e taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit.

2. Pezullimi i detyrimit hiqet në rastin kur individi heq dorë nga kërkesa e tij për blerjen dhe pagesën e menjëhershme të truallit, apo kur nuk paguan menjëherë detyrimin në ditën e caktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike.

3. Në rastet e heqjes së pezullimit të detyrimit, llogaritja e taksës bëhet sikur pezullimi të mos ishte vendosur asnjëherë.

4. Urdhri i pezullimit të detyrimit për pagesën e taksës dhe urdhri për heqjen e pezullimit bëhen nga Ministri i Financave.

Neni 20

**Dispozita kalimtare**

1. Deklarata për pagesën e taksës për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, për vitin në vazhdim, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bëhet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Në vitin në vazhdim, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, taksa llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e vitit të mbetur nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 21

**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7 të tij dhe një udhëzim të përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji.

Neni 22

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6553, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 271, datë 22.4.2010**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9655, DATË 11.12.2006 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 7, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Akademikët e Asociuar përfitojnë një shpërblim mujor në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 2**

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1  
**Raportimi i Akademisë së Shkencave**

Akademia e Shkencave paraqet, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, informacion për veprimtarinë vjetore pranë Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6554, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 272, datë 29.4.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË PESTË SHITESË TË MARRËVESHJES “PËR  
FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË PAQES NË EUROPËN JUGLINDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin e pestë shtesë të marrëveshjes “Për forcën shumëkombëshe të paqes në Europën Juglindore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6555, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**PROTOKOLLI I PESTË SHITESË**  
**I MARRËVESHJES MBI FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË PAQES NË EUROPËN JUGLINDORE**

Hyrje

Shtetet palë në marrëveshjen mbi forcën shumëkombëshe të paqes në Europën Juglindore (MPFSEE), nënshkruar në Shkup më 26 shtator 1998, siç shtuar dhe ndryshuar nga protokollin e parë shtesë i saj, nënshkruar në Athinë më 12 janar 1999, protokollin e dytë shtesë të nënshkruar në Bukuresht më 30 nëntor 1999, protokollin e tretë shtesë të nënshkruar në Athinë më 21 qershor 2000, protokollin e katërt shtesë të nënshkruar në Romë më 11 dhjetor 2002.

*Duke ripohuar* përkushtimin e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të parashikuara në marrëveshjen e MPFSEE(marrëveshja);

*Duke mbajtur parasysh* nevojat për të shtruar për zgjidhje dhe zgjidhur çështjet e dërgimit të HQ SEEBRIG;

*Duke dashur* që të përmirësojnë dhe përditësojnë më tej marrëveshjen me qëllim që të krijojnë kushtet për zgjerimin e nismës së MPFSEE;

*Duke ripërsëritur* rëndësinë e MPFSEE si një nismë rajonale për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin ndërmjet popujve të SEDM në qëndrueshmërinë rajonale dhe sigurinë ndërkombëtare, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Në nenin II të marrëveshjes do të futet një paragraf i ri me numër 5, që lexon si vijon:

“5. Të gjitha aspektet operationale dhe logjistike që lidhen me veprimtarinë e SEEBRIG do të udhëhiqen/zhvillohen, në parim dhe kur është e mundur, në përputhje me STANAG të NATO-s”.

## Neni 2

Në nenin IV të marrëveshjes, paragrafi 8 hiqet.  
Numërimi i paragrafëve në vijim ndryshon sipas këtij raporti.

## Neni 3

Në nenin IV, paragrafi 12 f i marrëveshjes ndryshohet dhe lexon si vijon:  
“f. Buxhet të përbashkët, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në- HQ SEEBRIG, personelin kryesor, misionin dhe buxhetet e stërvitjes”.

## Neni 4

Në nenin IV të marrëveshjes, në fund, futet një paragraf i ri që lexon si vijon:  
“ PMSC mund të japë medalje të misionit, mbi bazën e propozimit të COMSEEBRIG. Modeli dhe titulli duhet të miratohen dhe certifikohen nga PMSC”.

## Neni 5

Paragrafi 1 i nenit VII të marrëveshjes ndryshohet dhe lexon si vijon:  
“1. Struktura e HQ SEEBRIG, që përfshin një personel kryesor dhe vendosjen e kontingjencës (CE) për HQ SEEBRIG dhe ngritjen e personelit (PE) për personelin kryesor, përfshihen në aneksin C (shtabi i forcës) të kësaj marrëveshjeje. Vendet për personelin- përveç grupit të komandës së brigadës- do t'u ndahen palëve në përputhje me shkallën e kontributeve përkatëse të forcave të tyre. Vendet e MPFSEE me statusin e vëzhguesit mund të dërgojnë personel ndërlidhës pranë HQ SEEBRIG.”

## Neni 6

Në nenin VII të marrëveshjes, paragrafi 2 ndryshohet dhe lexon si vijon:  
“2. Grupi i komandës së brigadës do të përbëhet nga komandanti i brigadës, dy zëvendës, shefi i personelit dhe dy zëvendëshefa të personelit. Detyrat e komandantit të brigadës do të shkarkohen çdo dy vjet nga një gjeneral brigade i ushtrisë së njëres prej palëve, ndërsa një kolonel i vendit pritës do të shkarkojë nga detyrat shefin e personelit në brigadë. Postet e tjera kyçe të komandës do të jenë me rotacion njëherë në çdo dy ose tre vjet, ndërmjet palëve. Kohëzgjatja e saktë e rotacionit do t'i nënshtrohet këshillimeve paraprake. Të gjitha zëvendësimet e personelit kryesor të HQ SEEBRIG që i nënshtrohet rotacionit duhet të bëhet pas përfundimit të turit të parapërcaktuar në detyrë, përfshirë këtu edhe një periudhë mbivendosjeje. Zëvendësimi i sipërpërmendur do të jetë më mirë të bëhet përpara fundit të shtatorit të vitit përkatës. Periudha e sipërpërmendur e mbivendosjes zbatohet gjithashtu edhe për çdo zëvendësim të personelit kryesor kombëtar të HQ SEEBRIG. Vendi pritës do të përjashtohet nga rotacioni për COM, DCOM dhe DCOS.”

## Neni 7

Në nenin VIII të marrëveshjes, paragrafi 3 ndryshohet dhe lexon si vijon:  
“3. Stërvitje e kombinuar që përfshin veprimtari rikonjicioni, ushtrime stërvitore në postën e komandës apo në terren, si edhe ushtrime për menaxhimin e krizave do të kryhen në përputhje me plane dhe programe të rëna dakord bashkërisht.”

## Neni 8

Në nenin VIII të marrëveshjes do të futet një paragraf i ri 4 i marrëveshjes dhe lexon si vijon:  
“4. Përpara dërgimit në një operacion për mbështetjen e paqes/zonë të operimit (AOO) dhe duke iu nënshtuar miratimit të PMSC, HQ SEEBRIG “mund” të kryejë veprimtari të përbashkëta stërvitore bashkë me partnerët e aleancës/koalicionit, me qëllim që të përmbushë kërkesat e misionit të ardhshëm.”

#### Neni 9

Në nenin X të marrëveshjes, paragrafi 2 ndryshohet dhe lexon si vijon:

“2. Një sistem logjistik shumëkombësh duhet të zhvillohet mes palëve. Marrëveshje/memorandume mirëkuptimi të veçanta mund të arrihen, rast pas rasti, për të përcaktuar me hollësi parimet për të siguruar mbështetjen logjistike gjatë operacioneve dhe ushtrimeve”.

#### Neni 10

Në nenin X të marrëveshjes, paragrafi 3c ndryshohet dhe lexon si vijon:

“c.Trajtim urgjence në spitalet ushtarake apo civile pa asnjë rimbursim, për personelin kryesor dhe personat në varësi të tyre.”

#### Neni 11

Në nenin X të marrëveshjes, futet një paragraf i ri 3 dhe lexon si vijon:

“3.Me qëllim që të zbatohen dispozitat e marrëveshjes dhe protokolleve të saj shtesë, COMSEEBRIG mund të autorizohet, rast pas rasti, nga PMSC që të nënshkruajë marrëveshje teknike apo rregullime të tjera të nevojshme që të lidhen me misionin, në përputhje me procedurat standarde të operimit (SOPs) të SEEBRIG.”

Numërimi i paragrafëve vijues do të ndryshojë sipas këtij raporti.

#### Neni 12

Në nenin XI të marrëveshjes, paragrafi 2 ndryshohet dhe lexon si vijon:

“2. Marrëveshje të veçanta, rast pas rasti, mund të përcaktojnë me hollësi statusin e forcave kur brigada dërgohet për operacione të mbështetjes së paqes.”

#### Neni 13

Në nenin XII të marrëveshjes, paragrafi 3 ndryshohet dhe lexon si vijon:

“3. Pajisjet e blera përmes fondeve të përbashkëta janë pasuri e përbashkët e palëve. Pajisjet/shërbimet e dhëna apo të marra me qira, nëpërmjet fondeve të përbashkëta do të mbështeten duke përdorur buxhetin e përbashkët, bazuar në kontratë.

Statusi i pasurisë së përbashkët, pajisjeve/shërbimeve të dhëna apo të marra me qira, si dhe i pajisjeve vendase të siguruar nga vendi pritës për përdorim të përkohshëm, do të regjistrohen në lista inventarësh të veçanta dhe këto blerje do të përfshihen, si lista të plota, në raportet vjetore.”

#### Neni 14

Shkurtimi “WEU” zëvendësohet nga shkurtimi “EU” në të gjithë marrëveshjen dhe në protokollin e saj shtesë. Për më tepër, termi “USD” do të zëvendësohet nga “EURO” në të gjithë marrëveshjen dhe në protokollin e saj shtesë.

#### Neni 15

Në aneksin A të marrëveshjes, paragrafi 2 ndryshohet dhe lexon si vijon:

“Çdo batalion manovre do të përbëhet nga 2 ose 3 kompani, njësi të mbështetjes luftarake dhe njësi të mbështetjes së shërbimeve luftarake, nëse dhe siç do të kërkohet dhe duhet të ketë kapacitet të tilla, si: Teksti i nënparagrafëve a, b dhe c mbetet i pandryshuar.”

#### Neni 16

Në aneksin A të marrëveshjes, paragrafi 2d ndryshohet dhe lexon si vijon:

“d. Komunikimet, në parim, në përputhje me STANAG të NATO-s”

Neni 17

Në aneksin C të marrëveshjes, paragrafi 5a 7(a) (VII) ndryshohet dhe lexon si vijon:  
“(VII) Zhvillimi i udhëzimeve për ndërveprueshmërinë logjistike dhe atë CIS.”

Neni 18

Në aneksin C paragrafi 5a (7)(b) të marrëveshjes, ndryshohet paragrafi i ri (VI) dhe lexon si vijon:

“(VI) Bashkëpunimi i kërkesave të CIS në përputhje me shtojcën 6(CIS në vendndodhjet e dërgimit të HQ). Ata kritere mund të shtohen me anë të një vendimi të PMSC”.

Neni 19

Në aneksin C paragrafi 5a, futet një nënparagraf i ri(8) dhe lexon si vijon:

“(8) CIS në vendndodhjet e dërgimit të HQ, në përputhje me shtojcën 6, do të kërkonte rregullime të mëtejshme të veçanta ndërmjet palëve”.

Neni 20

Në aneksin C të marrëveshjes, paragrafi 6e ndryshohet dhe lexon si vijon:

“e. G5 (planet): planet afatmesme/afatgjata dhe ato të kontingjencës.”

Neni 21

Në aneksin C të marrëveshjes, futet paragrafi i ri 6i dhe lexon si vijon:

“i. G-9 (CIMIC): Planet dhe politikat e CIMIC, qendra e CIMIC, komisioni i përbashkët ushtarak/JMC, programet dhe projektet, funksionet ndërlidhëse të CIMIC dhe informacioni publik në kohë paqe nëse nuk është aktivizuar PIO.”

Nënparagrafët në vijim do të rinumërohen sipas këtij raporti.

Neni 22

Në aneksin D, neni II të marrëveshjes, paragrafi 5 ndryshohet dhe lexon si vijon:

“5. Personeli kryesor nënkupton personelin kyç në shtab, të siguruar nga palët në mënyrë të përhershme dhe të vendosur nën autoritetin e COMSEEERIG për planifikimin e zakonshëm dhe për funksione të tjera të personelit, siç përcaktohen me hollësi në shtojcën 3 të aneksit C.”

Neni 23

Në aneksin D të nenit IV të marrëveshjes, futet një paragraf i ri 4 dhe lexon si vijon:

“ Vendi pritës mund t'i përmbushë kriteret e CIS SEEERIG, në përputhje me shtojcën 2. Ato kritere mund të shtohen me vendim të PMSC”.

Neni 24

Në aneksin E neni 3 paragrafi 1c(1), futen nënparagrafët e rinj (h) dhe (i) dhe lexojnë si vijon:

“h) Të gjitha kostot për misionin për HQ SEEERIG, HQ COY dhe sinjalin COY do të financohen nga buxheti i përbashkët, përveç kostove për trajtimin mjekësor, pagat, dietat dhe shpenzimet e udhëtimit për personelin me leje për ROLE 3.

i) Kostot që do të rrjedhin nga ushqimi, akomodimi dhe udhëtimi për personelin e CE janë përgjegjësi e vendit, përveç periudhës TOA ndaj COMSEEERIG. Periudha TOA do të vendoset për të gjitha vendet nga PMSC për çdo mision të veçantë.”

#### Neni 25

Në aneksin E neni 3 paragrafi 1d të marrëveshjes, nënparagrafi (1) ndryshohet dhe lexon si vijon:

“(1) Ndarja e kostove është kontributi i secilës palë në buxhetin e përbashkët që do të llogaritet sipas numrit të posteve të forcës së paqes (PE) PHQ MPFSEE, të dhëna për secilën palë në kohë paqeje. Postet e lira, ato me rotacion dhe ato të përkohshme nuk do të prekin ndarjen e kostos. Në parim, ndarjet e kostos do të jenë në fuqi për të gjithë vitin fiskal. Si rrjedhim çdo ndryshim në dhënien e posteve PE gjatë vitit fiskal (FY) do të jetë në fuqi për ndarjet e kostos së palëve për vitin fiskal në vijim. Për qëllime të misionit, formula e ndarjes së kostos duhet të bazohet në numrin e posteve CE të dhëna në kuadrin e listës së pozicioneve të miratuara për atë mision të veçantë.”

#### Neni 26

Në aneksin E, neni 5 në fund të paragrafit 1 futet një fjali e re dhe lexon si vijon:

“Për gjendje të tjera të ndryshme nga ato në kohë paqeje (misione, operacione) pagesa e kontributeve do të bëhet në përputhje me vendimet e marra nga PMSC, bazuar në propozimet e HQ SEEBRIG.”

#### Neni 27

Në aneksin E neni 5, futet një paragraf i ri 6 dhe lexon si vijon:

“6. COM SEEBRIG është i autorizuar që të nënshkruajë kontrata që janë të nevojshme në kohë paqeje, me kusht që këto kufij financiarë efektivë të një fuqie të lirë të jenë në përputhje me shtojcën 1 tek aneksi E. Për periudhën e misionit, COMSEEBRIG do të ketë autoritetin nga PMSC që të nënshkruajë kontrata të nevojshme për misionin, me kusht që këto të jenë në përputhje me kufijtë financiarë efektivë të një fuqie të lirë deri në (30 000) euro për nivelin A, (137 000) euro për nivelin B dhe (211 000) euro për nivelin C. Mbi këto kufij COMSEEBRIG do të kërkojë një miratim të posaçëm nga PMSC.”

#### Neni 28

Titujt e shtojcave të aneksit A të marrëveshjes shtohen dhe lexojnë si vijon:

Shtojca-1: Struktura e përgjithshme e SEEBRIG.

Shtojca-2: Kontributet e palëve për trupat.

Shtojca-3: Organizimi i SEEBRIG.

#### Neni 29

Versionet e përditësuara të shtojcave 2 dhe 3 të aneksit A të marrëveshjes i bashkëngjiten këtij dokumenti.

#### Neni 30

Titujt e shtojcave të aneksit C të marrëveshjes shtohen dhe lexojnë si vijon:

Shtojca-1: Struktura e HQ SEEBRIG gjatë kohës së paqes.

Shtojca-2: Struktura e HQ SEEBRIG gjatë kohës së misioneve.

Shtojca-3: Lista e pozicioneve të HQ SEEBRIG gjatë kohës së paqes (NS).

Shtojca-4: CE e HQ SEEBRIG.

#### Neni 31

Versionet e përditësuara të shtojcave 1, 2,3 dhe 4 të aneksit C të marrëveshjes, si dhe shtojcat e reja 5 dhe 6 i bashkëngjiten këtij dokumenti. Titujt e shtojcave të reja 5 dhe 6 janë si vijon:

Shtojca-5: Lista provizore e pozicioneve të HQ SEEBRIG gjatë kohës së misioneve (PE dhe CE).

Shtojca-6: CIS në vendndodhjet e dërguara të HQ.

Neni 32

Titulli i shtojcës 1 të aneksit D të kësaj marrëveshjeje ndryshohet dhe lexon si vijon:

Shtojca-1: Mbështetja e vendit pritës për vendosjen dhe funksionimin e HQ SEEBRIG. Më tej, një version i përditësuar i shtojcës 1 dhe një shtojcë e re 2 e aneksit D i bashkëngjitet këtij dokumenti. Titulli i kësaj shtojce të re 2 është “Kriteret e CIS të SEEBRIG”.

Neni 33

Shtojca 1 e aneksit E të kësaj marrëveshjeje i bashkëngjitet këtij dokumenti.

Neni 34

Versioni i përditësuar i kartës mbi vendndodhjen e HQ SEEBRIG dhe postet e rëndësishme me rotacion, i cili ishte bashkëngjitur në protokollin e parë shtesë ndaj kësaj marrëveshjeje dhe ishte ndryshuar nga protokollin e katërt shtesë i saj, i bashkëngjitet këtij dokumenti.

Neni 35

Protokollin i nënshtrohet ratifikimit apo miratimit. Dhjetë ditë pasi të gjitha palët të kenë njoftuar depozituesin e marrëveshjes rreth plotësimit të procedurave të tyre të brendshme përkatëse, ky protokoll do të hyjë në fuqi. Depozituesi i marrëveshjes do të njoftojë palët për një depozitim të tillë, si dhe për datën e hyrjes në fuqi të këtij protokollin.

Nënshkruar në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ në shtatë kopje origjinale, në gjuhën angleze, nga një për secilën palë.



## MPFSEE /JO I KLISIFIKUAR

Shtojca 6 e aneksit C

(Bashkëngjitur protokollit të pestë shtesë ndaj marrëveshjes mbi forcën shumëkombëshe të paqes në Europën Juglindore)

### CIS NË VENDNDODHJEN E DËRGIMIT TË HQ

CIS në vendndodhjet e dërgimit të HQ është përgjegjësi e SEEBRIG HQ.

a) HQ mund të presë, akomodojë dhe integrojë shërbimet CIS të NATO-s në qendrën kryesore të HQ SEEBRIG, me kapacitet si vijon:

1. Lidhjet SATCOM në sistemet CIS të NATO-s;
2. Pajisjet LOS;
3. LOS me valë të shkurtër;
4. Kapacitetin për të instaluar një LAN NS të pjesshme;
5. Kapacitetin për të instaluar një LAN sekret të arenës;
6. Kapacitetin për të instaluar një LAN NU të pjesshëm;
7. Një PABX (tastierë) me pajisje telefonike të pjesshme për mbarim;
8. Telefona të sigurt (NBSVII);
9. Komplet të sigurt VTC.

b) SEEBRIG HQ mund të jetë i aftë të instalojë shërbimet në vijim në CP-të përkatëse dhe në HQ të batalionit: koment sqarues: kapacitetet në vijim u referohen kapaciteteve për të cilat janë përgjegjëse njësitë e HQ SEEBRIG /CIS.

1. Të gjitha CIS brenda BDE për C2. (koment sqarues: " Brenda brigadës" duhet të interpretohet si brenda dhe ndërmjet të gjitha postave të komandës së brigadës SEEBRIG dhe në 1 nivel nën SEEBRIG HQ (deri në 5 HQ të mëdha në varësi dhe deri 10 HQ të njësive të CS/CSS/formacione të tjera. Për më tepër: NATO apo organizata të tjera mund të sigurojnë transmetim përmes "tubit" për në qendrën kryesore të postës së komandës SEEBRIG. Pajisjet e nevojshme brenda postave të komandës SEEBRIG, transmetimet e nevojshme ndërmjet CP-ve të SEEBRIG dhe transmetimet e tjera të nevojshme, si dhe pajisjet e nevojshme për në nivelin tjetër më të ulët janë përgjegjësi e vendit/vendeve financuese/ SEEBRIG.

2. MCP mund të ketë mundësi hyrjeje në CIS të NATO-s duke pasur pajisje ndëroperuese.

3. Të gjitha pajisjet e nevojshme LAN dhe fuqinë punëtore për të zgjeruar LAN të pjesshme për ta bërë HQ tërësisht operacionale.

4. Pajisje zëri dhe pajisje të sigurta zëri shtesë.

5. Të gjitha CIS mund të sigurojnë C2 deri në një numër prej 5 formacionesh të mëdha në varësi dhe deri në 10 njësi të CS/ CSS/ formacione të tjera, me shërbimin në vijim, duke përfshirë këtu ambalazhime/ ndarje për këto njësi/formacione dhe personelin e nevojshëm CIS për ta instaluar, vënë në veprim dhe mirëmbajtur atë.

i) Rrjetin M/TS(Mision/arenë sekrete);

ii) Rrjetin NU;

iii) Zë të sigurt dhe të pasigurt;

iv) Fakse të dërgueshme;

v) Fakse të dërgueshme të sigurta;

vi) Kapacitet për të strehuar LAN NS (Sigurohet zonë e klasit II për NS LAN të pjesshëm të siguruar nga NATO);

vii) Qarqet dhe shërbimi mund të shtrihen deri në njësitë/formacionet marrëse pavarësisht nga pajisjet dhe standardet CIS të vetë atyre.

c) SEEBRIG mund të zhvillojë porta hyrëse për shkëmbimin e informacionit (IEG) për t'u lidhur me CIS të tjera të organizatës.

d) Njësitë integrale CIS vendosen pranë HQ, janë operacionale dhe mund të mbajnë kapacitete minimale të shërbimit si vijon:

1. Sistem të sigurt me shumë kanale të linjës kryesore (LOS), që garanton zë të sigurt dhe të pasigurt dhe komunikime të të dhënave për të lejuar shkëmbimin e të dhënave- duhet të sigurohet për të gjitha HQ BDE të dërguara, formacione më të mëdha në varësi dhe të gjitha HQ në varësi.

2. Qarqe të të dhënave me kapacitetin e duhur që janë të nevojshme për shërbime në vijim: Rrjetin sekret të misionit apo arenës, rrjetin NU (internet).

3. Lidhshmëri që mund të shtrihet tek formacionet anësore (së paku tek më i afërti djathtas) me një shërbim të ngjashëm.

4. Të jetë i aftë që ta shtrijë zërin e SEEBRIG dhe sistemet e të dhënave LOS/SATCOM.

5. Të jetë i aftë të shtrijë shërbimin PTT të vendit pritës.

6. Personeli dhe pajisjet SATCOM/ LOS të jenë të disponueshme për komunikim për të gjitha HQ të BDE, për një numër prej 5 formacionesh të mëdha në varësi dhe deri në 10 njësi të CS /CSS/ formacione të tjera.

7. HQ SEEBRIG mund të integrojë në CIS e tij të gjitha pajisjet e nevojshme (të marra nga NATO), me qëllim që të ketë mundësi hyrjeje në sistemet satelitore të NATO-s.

8. Pasuri të sigurta të CIS, si mjeteve dytësore, të jenë të disponueshme dhe operacionale (HF/VHF).

9. Ndarjet e komunikimeve të HQ mund të mbështesin deri në një numër prej 5 formacionesh të mëdha në varësi dhe deri në 10 njësi të CS/CSS/formacione të tjera, me shërbimin e nevojshëm CIS.

Rregullat e sigurisë së SEEBRIG, në lidhje me shtrirjen e CIS të SEEBRIG dhe kodimin për trupat që nuk i përkasin NATO-s, nuk kufizojnë operacionet.

## Shtojca 2 e aneksit D

(Bashkëngjitur protokollit të pestë shtesë ndaj marrëveshjes mbi forcën shumëkombëshe të paqes në Europën Juglindore)

### KRITERET E CIS PËR SEEBRIG

1. Lidhshmëria e CIS në kohë paqeje në HQ. Vendi pritës, mbi vullnetin e tij të lirë, mund të sigurojë HQ SEEBRIG kapacitete C2 dhe CIS të integruara, efikase dhe ndëroperuese, me qëllim që të kryejë operacione që përfshijnë një larmi të gjerë forcash, përfshirë këtu vende partnere dhe vende jo të NATO-s.

a) HQ mund të ketë hyrje tek CIS i NATO-s ku shërbimet në vijim të jenë të instaluar dhe operacionale:

1. Lidhshmërinë me CSC (Përbërësin me qark të alternuar), PTC (Përbërësin e paketës së transportit) dhe BME (Pajisjen e menaxhimit të gjerësisë së valës).

2. LAN të lartë me sistemin WAN/NS sekret të NATO-s. (Koment sqarues: Blerja dhe instalimi i pajisjeve CIS të HQ SEEBRIG duhet të jetë në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s në lidhje me CIS.

b) HQ mund të ketë një PABX digjital (tastierë) me:

1. Hyrje në NGCS të NATO-s (Sistemi i përgjithshëm i komunikimit të NATO-s).

2. Hyrje në PSTN vendor dhe ndërkombëtar.

3. Hyrje në sistemet ushtarake të zërit HN.

c) HQ mund të ketë një LAN jo të klasifikuar me hyrje në internet.

d) HQ mund të ketë pajisje për të ndërprerë shërbimet e CIS, në përputhje me standardet e NATO-s:

1. Telefona

2. Telefon atë sigurt

3. Fakse

4. Fakse të sigurt

5. Servera dhe përcjellës për të vënë në veprim rrjetet e nevojshme të të dhënave.

6. Pajisjet e nevojshme LAN/WAN.

7. Stacione pune për internet.

8. Pajisjet e duhura kriptë.

HQ SEEBRIG duhet të ketë më mirë pajisjet e veta kriptë të përputhshme me NATO-n të tilla, si telefona të sigurt, fakse të sigurta, pajisje të kodifikimit të njëkohshëm e kështu me radhë.

e) Shpërndarja kyçe e SEEBRIG dhe NATO-s është vendosur dhe planifikuar/zbatuar për dërgim.

f) ADP i HQ është bashkëkohor dhe mund të jetë i aftë që të procedojë të gjitha aplikimet e programeve kompjuterike të NATO-s në gjuhën angleze (Sistemin operativ, "Office Automation" dhe mjetet ndihmëse të rrjetit.

g) HQ mund të ketë terminale për qarqe analoge, digjitale dhe ISDN, të siguruara nga burime të tregut.

h) HQ ka lidhshmëri me sistemet ushtarake CIS të HN/ SEEBRIG qofshin këto statike apo të lëvizshme.

i) Njësitë/formacionet e bashkëngjitura mund të kenë CIS në HQ e tyre të paqes për lidhshmëri me SEEBRIG PHQ.

j) HQ është e aftë dhe ka fuqinë punëtore me përvojën e duhur që të kryejë:

1. Drejtimin e frekuencave.

2. Drejtimin e rrjetit dhe kontrollin e konfigurimit vendor.

3. Administrimin e rrjetit.

4. Ekspertizën dhe riparimet e instalimit të rrjetit.

k) Përdoruesit nga personeli i HQ janë të trajnuar në përdorimin e aplikimeve të programeve të posaçme kompjuterike dhe procedurave të COMPUSEC nga vendet, përpara caktimit, si edhe nga SEEBRIG.

**LIGJ**  
**Nr.10 273, datë 29.4.2010**

**PËR DOKUMENTIN ELEKTRONIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2  
**Objekti**

1. Ky ligj rregullon përdorimin e dokumentit elektronik nga personat fizikë, juridikë, publikë dhe privatë, programet dhe pajisjet elektronike të cilëve mundësojnë realizimin, prodhimin, transmetimin, marrjen, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të dokumentit elektronik.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet kur në legjislacionin në fuqi parashikohet shprehimisht përdorimi i formës shkresore.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dokument elektronik” është çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik apo nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, në përputhje me nenet 5 deri në 9 të këtij ligji. Përmbajtja e dokumentit elektronik përfshin të gjitha format e të dhënave, pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh.

2. “Cilësi dokumentare” është informacioni detyruar që i bashkëlidhet ose shoqëron dokumentin elektronik, të tillë si: nënshkrimi elektronik, koha e krijimit, emri i krijuesit dhe të dhëna të tjera që krijohen së bashku me dokumentin elektronik, me qëllim regjistrimin, ruajtjen e autenticitetit, tërësinë dhe vlefshmërinë e dokumentit elektronik përgjatë ciklit të dokumentimit.

3. “Cikël i dokumentit” është qarkullimi i dokumentit elektronik nga çasti i krijimit deri tek arkivimi ose asgjësimi i tij.

4. “Sistem kompjuterik” është ai sistem, i cili përbëhet prej pajisjeve, grupi pajisjesh apo pajisje të lidhura, ku njëra ose më shumë prej tyre janë vazhduese dhe që kryejnë një proces automatik të transmetimit të të dhënave.

5. “Formë numerike” është paraqitja e dokumentit elektronik në gjuhën shifrore të sistemit kompjuterik.

6. “Krijues” është personi fizik apo juridik, i cili, nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike, krijon, modelon dhe nënshkruan dokumentin elektronik, duke përdorur nënshkrimin elektronik.

7. “Dërgues” është personi fizik apo juridik, i cili e krijon dokumentin elektronik dhe e dërgon atë.

8. “Marrës” është personi fizik apo juridik, të cilit i adresohet dokumenti elektronik.
9. “Sistem i informacionit” është rrjeti i komunikimit të informacionit, që përfshin një bashkësi programesh, mjeteve të komunikimit elektronik dhe informacionit, metodat dhe procedurat e zbatueshme për përgatitjen, dërgimin, marrjen, kontrollin dhe sigurinë e dokumentit elektronik.
10. “Ndërmjetës informacioni” është operatori i autorizuar, që ofron rrjetin e komunikimeve elektronike dhe/ose faciliteteve shoqëruese për shkëmbimin dhe qarkullimin e dokumentit elektronik, për llogari të palëve të treta.

#### Neni 4

### **Përdorimi i dokumentit elektronik**

1. Përdorimi i dokumentit elektronik, në komunikimin midis dërguesit dhe marrësit, bëhet me pëlqim të dyanshëm.
2. Marrësi, i cili ka pranuar përdorimin dhe qarkullimin e dokumentit elektronik, nuk mund të refuzojë dokumentin elektronik në mënyrë të njëanshme, vetëm për faktin që ai është përgatitur, përdorur dhe qarkulluar në formë elektronike.

## KREU II

### VLEFSHMËRIA E DOKUMENTIT ELEKTRONIK

#### Neni 5

### **Vlefshmëria ligjore e dokumentit elektronik**

Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

#### Neni 6

### **Kritere të dokumentit elektronik**

Përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë:

- a) nënshkrim elektronik, sipas legjislacionit për nënshkrimin elektronik;
- b) të dhënat e krijuesit të dokumentit elektronik;
- c) pacënueshmërinë e dokumentit elektronik;
- ç) akses në përmbajtjen e dokumentit elektronik përgjatë gjithë ciklit të dokumentimit;
- d) qartësi në leximin e përmbajtjes së tij.

#### Neni 7

### **Struktura e dokumentit elektronik**

Dokumenti elektronik përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe ajo e posaçme e tij, të cilat janë të pandashme:

- a) pjesa e përgjithshme paraqet informacionin e përmbajtjes së dokumentit elektronik. Nëse dokumenti elektronik ka për qëllim t’i dërgohet një marrësi të përcaktuar, kjo pjesë përmban edhe emrin e marrësit;
- b) pjesa e posaçme përfshin një apo disa nënshkrime elektronike dhe informacion, që i përkasin kohës së krijimit të dokumentit elektronik, si dhe të dhëna të tjera, që i përkasin cilësisë dokumentare, sipas parashikimeve të nenit 3 pika 2 të këtij ligji.

#### Neni 8

### **Forma e paraqitjes së dokumentit elektronik**

Dokumenti elektronik ka formën e paraqitjes së tij të brendshme dhe formën e paraqitjes së jashtme:

a) forma e brendshme e paraqitjes së dokumentit elektronik është forma numerike, e përftuar nga përpunimi, dërgimi, marrja dhe ruajtja e dokumentit elektronik me një sistem programesh dhe pajisjesh kompjuterike;

b) forma e jashtme e paraqitjes së dokumentit elektronik është paraqitja vizuale dhe e kuptueshme e përmbajtjes së tij në ekranin e kompjuterit apo në pajisje të tjera të ngjashme ose në letër apo në mjete të tjera të materializuara, prodhuar nga forma e brendshme e paraqitjes, sipas shkronjës “a” të këtij neni.

#### Neni 9

##### **Uniciteti i dokumentit elektronik**

1. Çdo dokument elektronik është unik.
2. Nëse i njëjti person përgatit dy apo më shumë dokumente elektronike, me përmbajtje të njëjtë, në formë elektronike, ose kur njëri prej të cilëve është krijuar në letër, këto dokumente trajtohen si të pavarura.

#### Neni 10

##### **Kopja në letër e dokumentit elektronik**

1. Vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike kryhet nga personat e autorizuar nga titullari i institucionit.
2. Në të gjitha rastet e tjera, vërtetimi i kopjes në letër të dokumentit elektronik kryhet nga noteri publik. Rregullat dhe procedurat për vërtetimin nga noteri publik përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Drejtësisë.
3. Kopja në letër, e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik, duhet të mbajë bashkëlidhur shënimin “Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik”.

#### Neni 11

##### **Fuqia ligjore e dokumentit elektronik dhe e kopjes së tij në letër**

Dokumenti elektronik, si dhe kopja e tij në letër, e realizuar në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, janë të barasvlershme në kryerjen e transaksioneve a veprimeve juridike, ku kërkohet paraqitja e dokumentit elektronik apo kopja e tij në letër e vërtetuar.

#### Neni 12

##### **Dokumenti elektronik si mjet prove**

1. Dokumenti elektronik, që plotëson kriteret e nenit 6 të këtij ligji, përdoret si provë.
2. Organi që merr dokumentin elektronik si provë, përcakton vlefshmërinë e tij, duke mbajtur parasysh të dhënat për përgatitjen, ruajtjen, transmetimin, sigurinë dhe autenticitetin e nënshkrimit elektronik të tij, si dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

### KREU III

#### **PËRDORIMI DHE QARKULLIMI I DOKUMENTIT ELEKTRONIK**

#### Neni 13

##### **Qarkullimi i dokumentit elektronik**

Veprimet që lidhen me qarkullimin e dokumentit elektronik kryhen nëpërmjet çdo teknologjie të komunikimeve elektronike, që personat kanë në përdorimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur nga legjislacioni në fuqi kërkohet përdorimi i një mënyre të caktuar të komunikimeve elektronike.

#### Neni 14

### **Dërgimi i dokumentit elektronik**

Dokumenti elektronik konsiderohet i dërguar kur dërgohet:

- a) personalisht nga dërguesi; ose
  - b) nga personi i autorizuar prej dërguesit, për të kryer veprimet që kanë të bëjnë me dërgimin e dokumentit elektronik; ose
  - c) në mënyrë të automatizuar nga sistemi kompjuterik i dërguesit ose sistemi kompjuterik i personit të autorizuar nga dërguesi, për të kryer veprime në të.
2. Personave, të cilëve u drejtohet dokumenti elektronik, duhet t'u bëhet e njohur edhe dhënia e kompetencës së nënshkrimit elektronik nëpërmjet autorizimit. Nëse një gjë e tillë mungon dhe ka qenë e panjohur nga të tretët, të gjitha pasojat që mund të vijnë nga kjo padijeni janë në ngarkim të personit që ka nisur dokumentin.

#### Neni 15

### **Koha e dërgimit dhe e marrjes së dokumentit elektronik**

1. Koha kur dokumenti elektronik del nga sistemi kompjuterik i dërguesit dhe hyn në sistemin kompjuterik, që nuk është nën kontrollin e dërguesit apo nën kontrollin e një personi të autorizuar prej tij, konsiderohet si koha e dërgimit të dokumentit elektronik.
2. Koha kur dokumenti elektronik hyn në sistemin kompjuterik të marrësit dhe/ose në sistemin kompjuterik të personit të autorizuar prej tij, konsiderohet si kohë e marrjes të dokumentit elektronik.
3. Kur kërkohet marrja e konfirmimit të dokumentit elektronik, koha kur marrësi dërgon konfirmimin konsiderohet si koha e marrjes së dokumentit elektronik.
4. Koha e dërgimit dhe e marrjes konsiderohet si pjesë e veçantë e strukturës së dokumentit elektronik dhe ndalohet ndryshimi i saj.
5. Koha e regjistruar nga sistemi kompjuterik llogaritet sipas standardit të matjes së orës zyrtare në Republikën e Shqipërisë.
6. Paraqitja e kohës aktuale, e regjistruar nga sistemi kompjuterik apo i komunikimeve elektronike, duhet të jetë e njëjtë me standardet shqiptare të paraqitjes së orës dhe datës.

#### Neni 16

### **Marrja e dokumentit elektronik**

1. Dokumenti elektronik konsiderohet se është marrë kur:
  - a) merret personalisht nga marrësi; ose
  - b) nga personi i autorizuar prej marrësit; ose
  - c) në mënyrë të automatizuar në sistemin kompjuterik të marrësit ose personit të autorizuar prej tij.
2. Kur kërkohet nga dërguesi konfirmimi i marrjes së dokumentit elektronik, marrësi duhet të konfirmojë marrjen, në përputhje me kërkesat paraprake të dërguesit për njoftimin e marrjes.
3. Marrësi duhet të japë konfirmimin e marrjes së dokumentit elektronik me një veprim të paracaktuar nga dërguesi, përfshirë këtu edhe konfirmimin automatik të marrjes nga sistemi kompjuterik i marrësit.
4. Nëse konfirmimi i kërkuar nga dërguesi nuk merret brenda afatit kohor të përcaktuar, dërguesi duhet të njoftojë marrësin se nuk e ka marrë këtë konfirmim për dokumentin elektronik që ai ka dërguar.
5. Dispozitat e parashikuara në këtë nen zbatohen vetëm për veprimet e dërgimit dhe marrjes së dokumentit elektronik dhe nuk rregullojnë përmbajtjen e dokumentit elektronik apo rrethana të tjera, që lindin apo krijohen nga dërgimi ose marrja e dokumentit elektronik.

#### Neni 17

### **Shërbimet e ndërmjetësit të informacionit**

1. Qarkullimi i dokumentit elektronik, përveçse me sisteme të veta të informacionit, mund të kryhet edhe me sisteme të informacionit, që vihen në dispozicion nga ndërmjetësi i informacionit.

2. Kur qarkullimi i dokumentit elektronik kryhet nëpërmjet sistemit elektronik të ndërmjetësit të informacionit, ndërmjetësi mund të marrë përsipër ruajtjen dhe sigurinë e dokumentit elektronik në formën e tij origjinale, nëse i kërkohet nga palët.

3. Ndërmjetësi i informacionit i kryen shërbimet e veta sipas kushteve dhe kufijve të përcaktuar në këtë ligj, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore për ruajtjen dhe sigurinë e dokumenteve dhe procedurat e pranuar sipas marrëveshjeve paraprake me dërguesin dhe marrësin, të cilët përdorin sistemin e tij të komunikimit dhe/ose shërbimet plotësuese.

4. Ndërmjetësi i informacionit nuk është përgjegjës për përmbajtjen e dokumentit elektronik. Ndërmjetësit të informacionit i ndalohej të ndërhyjë në formën dhe përmbajtjen e dokumentit elektronik.

#### Neni 18

### **Ruajtja e dokumentit elektronik**

1. Dokumenti elektronik ruhet brenda kufijve kohorë të përcaktuar nga legjislacioni për arkivat.

2. Dokumenti elektronik ruhet në formën origjinale në sistemet respektive të informacionit, të cilat bëjnë të mundur qëndrueshmërinë e regjistrimeve elektronike gjatë afatit të përcaktuar të ruajtjes, si dhe në arkivin e dokumentit elektronik.

3. Arkivi i dokumentit elektronik duhet të sigurojë që:

a) dokumenti elektronik të arkivohet në formën që është krijuar, dërguar, marrë dhe ruajtur, duke mos ndryshuar tërësinë e tij, përfshirë të dhënat e nënshkrimit elektronik, si dhe të dhënat për vërtetimin e tij;

b) dokumenti elektronik, së bashku me nënshkrimin elektronik të përfshirë, të ruhet nëpërmjet procedurave dhe teknologjive, që sigurojnë garanci për pacenueshmërinë dhe tërësinë e tij gjatë gjithë kohës së ruajtjes, si dhe mosfshirjen pa autorizimin përkatës;

c) dokumenti elektronik, gjatë kohës së përcaktuar të ruajtjes, të jetë në formë të lexueshme, në dispozicion të personave që kanë të drejtën e aksesit në të;

ç) të mundësojë përcaktimin në mënyrë të besueshme të çdo dokumenti elektronik, të origjinës së tij, krijuesit, kohës, mënyrës dhe formën e marrjes në sistemin e ruajtjes;

d) procedura e mirëmbajtjes së sistemit të ruajtjes së dokumentit elektronik të mos cenojë paprekshmërinë e dokumentit elektronik.

#### Neni 19

### **Mbrojtja e dokumentit elektronik**

1. Pacenueshmëria e dokumentit elektronik sigurohet nëpërmjet procedurave dhe pajisjeve teknologjike të nevojshme për mbrojtjen e dokumentit elektronik gjatë ciklit të dokumentit.

2. Operatorët e sistemeve të informacionit janë të detyruar të instalojnë pajisje për mbrojtjen e sistemeve dhe dokumenteve elektronike, ndaj cenimit nga faktorët e jashtëm për mbrojtjen e sistemeve dhe dokumenteve që qarkullojnë në sistemet e tyre të informacionit, si dhe të informojnë përdoruesit për rreziqet dhe mënyrat e shmangies së tyre.

3. Në rast se, pavarësisht nga masat mbrojtëse, integriteti i dokumentit elektronik cenohet, për shkak të ndërhyrjeve në sistemet e informacionit, përmbajtja e dokumentit elektronik bëhet e pavlefshme për marrësin.

#### KREU IV

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 20

### **Dokumenti elektronik që përmban informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”**

Përdorimi i dokumenti elektronik, që përmban informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, rregullohet në përputhje me legjislacionin për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.



Neni 21  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për fushën e shoqërisë së informacionit që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 1.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 2.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë rregullat për nënshkrimin, dërgimin, marrjen, mënyrën e sigurimit, mbrojtjes, ruajtjes, arkivimit dhe asgjësimit të dokumentit elektronik.

Neni 22  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6556, datë 12.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.5.2010

Doli nga shtypi më 21.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 44 lekë